

KOSOVA

Ballina: Marigona Kololli

A JEMI NË
UDHËN E ZOTIT

PSE RUGOVASIT I SHTRIJNË
KËMBËT KAH MUJNË

JAM BËRË PËR
HAJMALI TË MADHE

MË SHUMË I FRIKËSOHEM
GRUAS SE SULLTANIT

"MARIGONA MOE"

NJË HISTORI SUKSESI
NËNSHKRUAR NGA
MARIGONA KOLOLLI



feel the legend



ANTALYA | TÜRKİYE

“Marigona Moe” është një nga klinikat estetike më të njohura e më serioze në Zvicër, që së fundi ka hapur dyert edhe në Kosovë.

Me një gamë të gjerë shërbimesh estetike, që realizohen nga një staf profesional e i kujdesshëm dhe me aparaturën më bashkëkohore e inovative, “Marigona Moe” jo rastësisht ka një klientelë të gjerë e gjithmonë tejet të kënaqur me shërbimet, trajtimin dhe kujdesin profesional e etik.

*Marigona Kololli, një grua ambicioze, e drejtë, koherente dhe tejet elegante, e ka ngritur këtë biznes që ka për qëllim t’i bëjë njerëzit të duken dhe të ndihen bukur, këndshëm dhe me vetëbesim. Kush është Marigona?
E njohim bashkë...*



“MARIGONA MOE”

NJË HISTORI SUKSESI

NËNSHKRUAR NGA

MARIGONA KOLOLLI



Marigonë, si do ta prezantoje veten?

- Si një grua që mundohet të jetojë mirë dhe lumtur. Sa të mundem i kushtoj kohë familjes dhe miqve, pasi jam tejet e angazhuar dhe puna nuk më lë shumë hapësirë për t'i bërë të gjitha gjërat njëkohësisht. Gjithsesi, mundohem të gjej kohë për gjërat dhe njerëzit që i dua. Jam punëtore, e drejtë dhe e vendosur. Jam e fokusuar në benefite dhe jetë e punë cilësore.

E të tjerët si të përshkruajnë?

- Bashkëpunëtorët në bizneset e mi në Zvicër më përshkruajnë si njeri i drejtë, real dhe i besueshëm. Mendoj që në fushën e estetikës është e domosdoshme të jesh real dhe të japësh më të mirën, si për vetveten.

Suksesi yt më i madh në jetë?

- Pa dyshim se është familja e shëndetshme dhe tre fëmijët e mi, pa përjashtuar edhe bizneset "Marigona Moe" në Zvicër dhe "LA MOÉ", që është linja ime e kremrave luksoze dhe parfumeve të ndryshëm "Label", krijuar nga unë.

A ka një ëndërr që nuk të është bërë realitet?

- Jam gati duke e jetuar jetën e ëndrrave, pasi jetoj mes dy vendeve më të bukura në botë, Kosovës dhe Zvicrës. Kam ëndërr të jetoj më shumë në Kosovë sesa në Zvicër.

Cili është shkollimi yt?

- Fillimisht kam kryer shkollë për një drejtim tjetër, meqë prindërit më këshillonin ashtu, duke më thënë se pa një diplomë zanati nuk ka të ardhme në Zvicër. I falënderoj për këtë, por unë nuk punova për atë që u shkollova. Zgjedha më pas të aftësohesha e profesionalizohesha në

fushën e estetikës dhe mendoj se kam bërë zgjedhjen më të mirë të mundshme për veten dhe të ardhmen time.

Pse vendose të bëheshe pjesë e botës së bukurisë dhe estetikës?

- Gjithmonë më kanë impresionuar ndryshimet për të mirë, andaj mendoja që ky drejtim është puna e ëndrrave të mia.

Ju jepni edhe mësim, apo?

- Po, që shumë vjet jap mësim në drejtimin Microblading në Zvicër. Jam me diplomë Master në "Swiss Color".

Të flasim pak për klinikat tua estetike në Zvicër dhe Kosovë?

- Klinikat estetike si në Zvicër, ashtu edhe në Kosovë kanë të njëjtin emër - "Marigona Moe" dhe ofrojnë shërbime estetike me profesionalizëm të lartë. Gama e shërbimeve është e gjerë dhe numri i klientëve i madh.

Njëra qendër estetike gjendet në Sant Gallen të Zvicrës, e hapur që 10 vjet, kurse tjetra në Cyrih, e që është klinikë për ndryshime më të mëdha, ku kam për partner Dr. Simon, me të cilin bashkëpunojmë prej kohësh.

Së fundi kemi hapur edhe klinikën estetike "Marigona Moe" në Prishtinë, në Arbëri (Dragodan), ku gjithashtu po bëhet një punë e shkëlqyer.

Çfarë kuptimi kanë inicialet MOE?

- Janë inicialet e tre fëmijëve të mi. MOE, pra, është tejet personale dhe e zemrës.

Çfarë shërbimesh ofrohen në "Marigona Moe"?

- Shërbimet janë të shumta, duke filluar nga microblading, microneedling, rimodelimi i hundës, zbutja e rrudhave, heqja e tatuazheve etj.

Ju, personalisht, çfarë keni “specialitet”?

- Jam e specializuar në drejtim të fytyrës, njëjtë është edhe stafi im.

Sa i përket teknologjisë, në Kosovë kam sjellë nga Zvicra aparaturën më të avancuar, siç është laseri për heqjen e qimeve, të tatuazheve, apo të fytyrës me zero dhimbje.

Të gjitha shërbimet te ne janë speciale dhe ekskluzive.

Çfarë mendon se të ka bërë kaq të njohur?

- Puna, profesionalizmi i treguar në çdo shërbim e tretman dhe fokusimi i plotë në precizion.

Të gjitha këto më kanë bërë mua dhe biznesin tim “Mari-gona Moe” të besueshëm dhe të kërkuar.

“LA MOË”, linja juaj e kremrave dhe parfumeve luksoze është tejet unike. Çfarë mund të na thuash më shumë?

- “LA MOË” është krijuar me delikatesë, pasion e dashuri. I kam kushtuar rëndësi deri në detajet më të vogla.

Në të vërtetë, “LA MOË” ka një rëndësi të veçantë për mua, andaj është temë e gjatë, por po e përmbledhë me pak fjalë: Krema e ditës “La Creme Riche” përmban kaviar, ari, perlë etj. Parfimet janë “Rubin”, “Blu Hop” etj dhe janë me ngjyra si llojet e diamanteve, ndërkaq brenda kanë nga një gur diamanti, sigurisht jo real.

Jeta jote private?

- Jam e martuar. I kam tre fëmijë dhe i dua shumë. Jetoj si krejt shqiptarët, as më shumë e as më pak.


Pasioni i fshehur?

- E dua natyrën, më pëlqen ta eksploroj. Gjithashtu, jam dashamirëse e qenve.

Ju faleminderit për intervistë!

- Faleminderit juve!

Nderim Neziri



Im koleg me veturë luksoze, unë eci këmbë...

Te ne, në Kosovë, hasë në gjithçka: në njerëz të varfër e të pasur, në të zhurmshëm e të heshtur, në njerëz që derdhin lot dhe në të tillë që janë në qejf nga rakia, në shtëpi kasolle e në pallate shumëkatëshe...

Prishtina është bërë vend i zhurmshëm. Kushdo që vjen nga jashtë thotë se këtu ka zhurmë, ka jetë. Se atje ku jetojnë e punojnë nuk dëgjohet kush për së gjalli, secili shikon punën e vet, rrugën e vet. Te ne kafenetë janë plot me njerëz. Zhurmë sa të duash. Tym duhani si mjegulla e dendur dimrit kur e përfshinë Aeroportin e Prishtinës. Thënë shkurt, vetëm pak ditë para se t'i qes në letër këta pak rreshta, isha në kafenenë përballë Redaksisë. Aty pi kafenë e mëngjesit me shokët e punës. Përballë kafenesë ndodhet shkolla "Elena Gjika" dhe po qëlllove në kohën kur nxënësit dhe arsimtarët ndodhen në pushim, zhurma shkon deri në kupë të qiellit! Kështu ishte sot, por ishte edhe dje...

SYZET MBI FLOKË!

Te ne, si çdo herë, tejet në modë janë syzet. Të rralla janë femrat pa syze. Madje, edhe meshkujt! Por, pakkush i mbanë në sy. Pjesa dërmuese i mbajnë mbi flokë! I mbrojnë flokët nga dielli pranveror, apo? Ndoshta e dinë se syzet jo origjinale i dëmtojnë sytë dhe mu për këtë i mbajnë mbi flokë, që të tregojnë se kanë syze, se janë në trend me

kohën...

A mos kënaqemi sa për sy e faqe? A jemi ne, kosovarët, në udhë të Zotit apo këtë e bëjmë sa për sy e faqe? "Po i bëjnë njëmijë të zeza dhe po shkojnë në xhami". Këto fjalë i dëgjova nga një shitës në "Tregun e Gjellbër" në Prishtinë, teksa bisedonte me një blerës, e që biseda e tyre vazhdoi edhe tutje, kryesisht rreth fesë... Dhe, nganjëherë, "fjalët e çarshisë" janë të vërteta, janë për t'u besuar...

IM KOLEG ME VETURË LUKSOZE

Të gjithë jemi dëshmitarë të një sërë ngjarjesh interesante nga jeta e përditshme. Ngjarje që lidhen me njerëz të ndryshëm, me të atillë që ecin në këmbë dhe me të atillë që nuk zbresin nga vetura veçse kur hyjnë në shtëpi.

Madje, edhe bukë kur shkojnë me ble shkojnë me veturë!

Por, edhe për këtë kam një fakt.


Një koleg imi, i cili, shyqyr Zotit i ka punët mirë, ka veturë luksoze dhe një hap nuk e bënë pa të! Po të ketë mundësi me veturë do të hynte brenda edhe në Redaksi!

Sidoqoftë, apetitet i ka edhe më të mëdha: Do e ndërrojë veturën me një edhe më luksoze!

E, pse, e di ai!

I. I.

A KA NJERËZ ME SHUMË FYTYRA?



Cila është fytyra jonë e vërtetë po të gjendemi para mbretit, para lypësit, para gruas, para të dashurës?

Njerëzit kanë shumë ambicie, sulen pas parasë dhe vrapojnë pas pasurisë.
Kanë frikë nga sëmundjet.
Kanë frikë nga vetmia...
Nuk dinë të jetojnë vetë me vetveten.
Nuk kanë rahat të brendshme.
Janë të shqetësuar dhe të brengosur. Bredhin. Kanë frikë nga e panjohura.
E, jeta jonë rrjedh, ecë e shqetësuar.
Përditë, përnatë, shkaku i takimit me të këqijtë jemi të pakënaqur, me ankth, shpesh të lodhur, të rraskapitur, nervoz, të pashpresë.
E, ku të ikim nga të gjitha këto?
Në ndonjë vend të lartë malor?
Por, edhe aty, mbase, do të na shqetësojnë erërat e forta, stuhitë?!
E, ku ta gjejmë një vend që të na qetësohet

shpirti?
Ku gjendet ai vend?

*

Po të gjendeshe para mbretit, çfarë pamje do kishte fytyra jote?
Po të gjendeshe para lypësit, çfarë maske do shihej në fytyrën tënde?
Po të gjendeshe ulur para gruas a para të dashurës, cila pamje e fytyrës sate do të jetë e vërteta?
Pse, në secilën situatë, në secilën pozitë, në fytyrë kemi një maskë të veçantë?
Cila është fytyra jonë?
Cila është fytyra e vërtetë?
Pse maskohemi?
Pse fshihemi?

Gani DILI

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Ardita Dili
Edona Vllasaliu - Bajoku
Xheneta Spahiu
Denisa Oruqi

Dizajni:
Labinot Bërbotovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com



Kur më shkeli këmba për herë të parë në Shqipëri...

Ditë më parë, teksa pinim kafe e bisedonim për punën tonë në gazetari, shefi im, Gani Dili, më ktheu me mendje 34 vjet pas, kohë kur për herë të parë shkela në Shqipëri, më 1 shtator 1990, kur shkela në tokën e amshuar, tokën e ëndrrave, në Shqipërinë që e deshëm sa edhe Kosovën. Por, zhgënjimi qe shumë i madh!

Profesor Naim Basha, emigrant nga Shqipëria, në Normalen e Ferizajt, na i nguliti në kokë vargjet "Ku na duket balta, më e ëmbël se mjalta - në Shqipëri".

Por, kur këmbët shkelën në Shqipëri, në pikën kufitare Kapshticë (kufiri Greqi-Shqipëri), jo mjaltë, por pamje tmerri pashë kudo, e që, edhe tash, pas 34 vjetësh, nuk më hiqen dot nga mendja...

Aso kohe turma e madhe e njerëzve në kufi që kërkonin bukë ishte e madhe. Fëmijë të leckosur si në tregimin "Luli i vocërr"; burra e gra me flokë të palarë si në vargjet "Kafshatë që s'kapërdihet asht or vëlla mjerimi" të Migjenit, më emocionuan, më prekën në shpirt.

M'u mbushën sytë lot...

M'u kujtuan lisat e gjatë e fushat e gjëra me lule të Naimit, e që nuk shihja kund lisa e as fusha veç bunkerë e kodrina boshe, të thata, të zhveshura e rrugica me pluhur si në Saharë... S'mund ta përmbaja veten nga emocionet, nga lotët, aq nga kureshtja që shkela në tokën e ëndërruar, e po aq nga pamjet trishtuese që asnjëherë nuk i kisha imagjinuar se mund t'i shihja në Shqipërinë e ëndrrave të brezit tim, dhe jo vetëm të brezit tim...

HIQU MORE SHKURTE FEJZËS!

Pasi u largova nga pika kufitare, në një ngushticë rruge, vetura ime u rrethua

nga shumë vetë, të rinj e të moshuar. E ula xhamin e veturës dhe i përshëndeta.

Njëri, pasi u shikua në pasqyrën e veturës që ndodhej në anën e majtë, u mundua ta nxirrte pasqyrën, por ajo nuk shkoqej.

Tjetri kërkonte çamçakëz.

Një tjetër - çokollatë.

E, një tjetër më tha:

"Paske edhe kasetofon në makinë, a?!".

"Po", ia ktheva.

"Ke edhe kaseta?", më pyeti.

"Po. E do një?", i thashë.

"Po", më tha.

"E do Shkurte Fejzën, Shyhrete Behullin, Remzie Osmanin?".

"Çfarë Shkurte Fejza, bre!". Hiqu saj! A e ke Vesna Zmijanacin?", ma ktheu.

"Çka po thua, bre?! Çfarë Vesna Zmijanaci! A di serbisht, a?!", ia ktheva i nevrikosur.

"Jo, nuk di serbisht, por këndon bukur!", më thotë ai shumë i qetë.

"Po, ku këndon bukur Vesna Zmijanaci, bre?!", i them shumë i nervozuar.

"Aiii, po ti nuk po e kuptojshë artin!", ma ktheu.

"Jo, nuk unë e kuptoj artin e Vesna Zmijanacit dhe as që dua ta kuptoj!", i them, teksa dua të largohem, por masa e njerëzve ma kishte rrethuar veturën dhe nuk mund të vazhdoja tutje, derisa erdhën dy ushtarë dhe i larguan nga rruga, sepse edhe dy vetura të tjera pas meje, me regjistrim të Kosovës, nuk mund të vazhdonin rrugën tutje, pa ecur unë, meqë rruga ishte e ngushtë.

BUNKERËT NË VARREZA!

Jo larg pikës kufitare kudo shihje bunkerë...

Disa të vegjël e në mesin e tyre një i madh, të drejtuar drejt Greqisë!

E gjatë e me plot rreziqe ishte rruga nga pika kufitare Kapshticë për në Korçë e Elbasan, sepse hasja edhe në fëmijë që gjuanin anash, madje edhe me gurë!

Rrugët me gropa, plantacionet e ullishteve të shkatërruara (kishin mbetur vetëm drunjtë, meqë degët ua kishin thyer dhe dukeshin trishtueshëm).

MË ZURI NATA - BUJTA NË ELBASAN

Pas disa orë rrugë mbërrita në Elbasan. Mezi prisja ta shihja, sepse, si nxënës i Normales së Prishtinës, në mbrëmje, kah ktheheshim nga shkolla, teksa ecnim në grupe nëpër Touk-bahçe, në errësirë këndonim këngën "Elbasani i bukur"...

"Rreth e rreth kalasë

Këndon kumria

Si ylber me ngjyra

Vezullojnë dritat

Elbasani i bukur



Elbasan".

Por, prit se po shoh drita, e dritë për "ilaç", siç thuhet në popull, nuk shihja! Errësirë kudo, madje edhe në qendër të Elbasanit, ku ndodhej hoteli i qytetit, e ku takova Albert Tfanin, këngëtar i njohur i Elbasanit.

I thashë se te ne kënga "Elbasani i bukur" këndohet shumë...

"Këndohet, por ja se si është në të vërtetë!", ma ktheu me keqardhje Alberti.

NË HOTEL TIRANA S'KISHTE AS KAFE!

Në Tiranë arrita të nesërmen. U vendosa në Hotelin "Tirana", përballë shtatores së Skënderbeut.

Jo që s'kishte ushqim, por as kafe, madje!

Një gotë ujë me një rrishtë limon e quanin limonadë!

Furrat e bukës ishin pa bukë. Shitoret të boshatisura. Xhamat e lokaleve, kryesisht, ishin të thyer.

Hynin fëmijët për dere e dilnin dritare!

Në autobusin e qytetit njerëzit rrinin në këmbë dhe me ombrella të hapura, sepse shiu që binte pikonte mbi kokat e tyre...

Të nesërmen, kur arrita në Durrës, në plazhin disa kilometra të gjatë, ishte vetëm hotel "Adriatiku". Nuk kishte vend për fjetje, sepse, sipas personelit të hotelit, vendet janë të rezervuara vetëm për delegacionet e huaja... Bunkerët si kërpudhat shiheshin kudo nëpër plazh, me dritaret e vogla drejt detit...

Aq më keq, bunker pashë edhe në varreza!

Dhe, çka jo tjetër?!

DUHET ME TË GJOBIT!

Pas një nate që bujta në një hotel të vjetër në qytetin e vjetër të Durrësit, kur arrita në Kavajë, në qendër të qytetit, ku rrallë shihej ndonjë veturë, e edhe ato që qarkullonin ishin me regjistrim të Kosovës, një polic më doli në rrugë dhe ma bëri me dorë të ndalem.

E ndala veturën.

Hapa derën dhe e përshëndeta.

Dhe, pasi më përshëndeti më kërkoi dokumentet.

E, kur ia dhashë, më tha:

"Duhet me të gjobit!"

"Pse?", e pyeta.

"Ke qenë shpejt!", ma ktheu.

"Jo, nuk kam qenë shpejt. Jam kureshtar ta shoh qytetin, sepse jam për herë të parë në Shqipëri. E, me çka e mate shpejtësinë?", i thashë.

"Me syl!", ma ktheu.

"Shpejtësia nuk matet me sy, por me radar", i them unë.

"Radar nuk kemi! Po ti, ku e di?!", më pyet me habi.

"E di, sepse te ne, në Kosovë, e edhe kudo tjetër ku kam qenë në shtete të Evropës, shpejtësia matet me radar!", i them.

"Çka punon ti?", më pyeti.

"Jam gazetar", ia ktheva.

"A ke dokument të gazetarit", më tha.

"Po", i thashë dhe nxora nga kuleta librezën e gazetarisë dhe ia dhashë.

E, pasi e lexoi, e rrotulloi sa para e sa prapa dhe më tha: "Po, ti, me të vërtetë qenke gazetar! E, meqë je gazetar nuk të dënojmë."

SHUMË VJET NUK SHKELA MË NË TOKËN "E AMSHUAR"...

Dhe, shumë vjet nuk shkela më në tokën "e amshuar".

Sepse, zhgënjimi ishte i madh dhe nuk dëshiroja t'i shihja edhe njëherë ato pamje trishtuese...

Isa ILAZI



Rahmet pastë nëna!

Sa herë më del gjumi në ag mëngjesi, më kujtohet nëna pranë luleve në ballkon. Lulet janë rritur e kanë çelur çdo vit shumë e më shumë, por nëna ka vdekur, duke i lënë ato të rriten e ta zbukurojnë ballkonin...

Njeriu nuk mund ta lirojë unin e vet nga nëna dhe baba, edhe kur në mes tyre ka momente kritike të hidhërimeve dhe qortimeve.

Nënën s'mund ta zgjedhësh, ashtu siç s'mund ta zgjedhësh as babën. Më kujtohet halla kur shkonte t'i vizitonte djemtë në burgjet e Serbisë, në kohën e Jugosllavisë.

E kishte vështirë teksa priste në dhomat ku takohej me të bijtë e burgosur. Njërin e kishte në Pozharevc e tjetrin në Nish, qytete në Serbi.

Dhe, sa herë që kthehej nga vizita që ua bënte djemve, kthehej me shpresa të humbura...

E, unë, para pak ditësh, teksa shkoja në një qendër të tillë për ta parë Drinin, mendoja se sot jemi në Kosovën ku gjërat nuk e kanë përmasën e rrezikut të dikurshëm dhe se njeriu mund të merr frymë lirisht edhe në burg, sepse në burgjet tona tash flitet gjuha jonë dhe ku shumë gjëra janë dukshëm më të mira se në burgjet e Serbisë që i vriste shqiptarët...

PSE BURGJET JANË TË NEVOJSHME?

Mendoj se është mirë që i kemi burgjet, në radhë të parë, duke parë e lexuar çdo ditë së çfarë po ndodh mes njerëzve tanë.

Them me vete: Edhe po të jesh nënë a babë, nuk ke pse mërzhitesh edhe kur shkon në vende me mure të larta betoni dhe gjemba, edhe pse kur i sheh ta kujton një robërinë!

Kujtesa për të kaluarën e burgjeve, ku vdisnin rinia shqiptare në Jugosllavi, na e bënë më të lehtë të tashmen, sepse tash gjërat qëndrojnë shumë më mirë. Sidoqoftë, kur u takuam me Drinin, andej xhamave të ndarjes fizike, ai ia rroku duart

nënës së vet dhe e shikoi drejt në sy, duke mos u bindur se nënën e kishte mirë...

"Pse më shikon habitshëm Drin?! Je përmalluar për mua?!", i tha nëna e tij.

"Mbrëmë pashë ëndërr. Flija me ty. Më shtrëngoje në gjì..."

E, kur më doli gjumi, shikova orën. Ishte 3 e mëngjesit. U rrotullova në krahun tjetër, sepse e pashë veten ku jam..."

Në çast na pushtuan lotët të treve...

Por, meqë jam më zemërgjerë se gruaja, thashë: Kalojnë të gjitha...

Sidoqoftë, njerëzit në momente të caktuara kanë të drejtë të qajnë edhe nëse janë burra të fortë, edhe nëse janë nëna të forta.

NËNA ME TRE FËMIJË U MBYTËN NË BUNË!

Meqë është fjala për nënat, këto ditë ndodhi një tragjedi e madhe. Nëna me tre fëmijë gjetën vdekjen në lumin Buna, afër Shkodrës, shkak i dhunës në shtëpi nga vjehri dhe burri.

Dhe, duke mos gjetur zgjidhje nga dhuna e vazhdueshme, nëna i merr tre fëmijët dhe "shpëtimin" e sheh në lumin Buna! E tmerrshme, a?!

S. M.

Ju njohim me Afërdita Begaj, të mirënjohuren e fushës së estetikës

Afërdita Begaj është profesioniste e fushës së estetikës dhe bukurisë, e lindur në Prizren, e shkolluar në Colping. Jeton dhe vepron në qytetin e bukur të Prizrenit, ku edhe ka qendren e njohur estetike “Afërdita Begaj Beauty Center”.



Afërdita është rritur në një familje intelektuale, me babain avokat dhe nënën farmacistë. Edhe në familjen ku është martuar, janë familje mjekësh, andaj është e lumtur ku ka lindur dhe ku e vijon jetën.

Në vitin 2017 pasi është bërë nënë, ka vijuar fakultetin e infermierisë në Rezonancë, ku njëkohësisht ka punuar si estetiste në Prishtinë.

Në vitin 2022 ka startuar punë në një qendër estetike zvicëranë në Prizren, ku edhe bëri më të mirën e saj. Pas një pune të gjatë e të sukseshme në këtë qendër, Afërdita Begaj hapi sallonin e saj. “Në estetikën time posedoj të gjitha aparatat origjinalë nga brendi Alexandrite. Jam e çertifikuar nga shumë Akademi estetike dhe kam kënaqësinë të marrë ftesa nga Akademi të ndryshme evropiane. Edhe pse punën e bëj me sy mbyllur, sërish marrë pjesë në trajnime të udhëhequra nga trajnerët më të njohur në fushën e estetikës”, thotë Afërdita.

“Falë Zotit, bashkëshortit dhe familjes time, sot jam e përbushur në biznesin tim. Mëngjesin e filloi me buzëqeshje dhe mbrëmjen e mbylli me dashuri. Pra, jam e plotësuar dhe e kënaqur me jetën time”. Afërdita Begaj është nënë e katër fëmijëve, ndërkohë që punën e bën me pasion të madh dhe deklaron se klientët janë si familje për të.

*Së shpejti
me lokalin e ri*

Ku ndodhet “Kroi i lotëve” ndërmjet Kosovës e Shqipërisë?

Babë Maliqi, nga brezi kufitar në Shqipëri, kishte shkuar në Prizren në pazar. Ai nuk dinte se atë ditë të vitit 1947 do të blindohej kufiri ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Ai mbeti në Prizren dhe kurrë nuk mundi më të kthehej në shtëpinë e tij në lagjen “Pogaj”, ku i mbeti “jetim” për së gjalli i biri, Halili. Maliqi vdes në Prizren, e i biri, Halili, kurrë nuk ia gjeti varrin...

Fshati malor Gorozhup, i Pashtrikut të Hasit, ka histori të dhimbshme. Në vitin 1912 fuqitë e mëdha copëtuan tokat shqiptare, duke e vendosur kufirin Kosovë-Shqipëri në mes të fshatit Gorozhup, e që u nda në dy fshatra: Gorozhupi i Shqipërisë, që mbeti në Shqipëri dhe Gorozhupi i Kosovës, që mbeti në Jugosllavi.

Kufi të hekurt dhe regjim totalitar shteti jugosllav vendosi në vitin 1947, duke vendosur aty karakollin dhe kazermat dhe duke i dhënë fund lidhjes tradicionale të Gorozhupit.

Kështu, pas vendosjes së kufirit të hekurt dhe dhunës ndaj popullatës, shteti komu-

nist i Jugosllavisë vuri rend vdekjeprurës në tërë zonën kufitare të Gorozhupit, duke neutralizuar disa kilometra male dhe tokë pune, që u kishte shërbyer banorëve vendës, edhe pse ishte tokë kodrinore-malore në mes të fshatit të ndarë Gorozhup.

HISTORIA E DHIMBJES...

Ndarja e Gorozhupit, megjithatë, e ka historinë e vet të dhimbjes. Historia nuk është shkruar e tëra të karakollët serbo-jugosllavë në krye të fshatit, por është shkruar pikërisht në luginën mes dy Gorozhupëve, aty ku ishte kroi i përbashkët i të dy lagjeve të fshatit, por që e ndante kufiri

shtetëror. Kështu, kroi u bë i rëndë për të mbushur ujë, sepse edhe uji i pijes u mor nën diktaturën ushtarake të regjimit. Ishin mbi dy kilometra rrugë të vështira për ecje nga karakolli i ushtrisë jugosllave deri te kroi në luginë, rrugë që duhej kaluar për çdo ditë dhe, për më keq, kjo rrugë nuk do të mbetej vetëm një rrugë gurësh nëpër luginë, por ferr jete për banorët që duhej të merrnin ujë në krua, si burim jete të përditshme, meqë uji në Has ishte i pakët dhe vështirë gjendej. Me vendosjen e kufirit ndërkufitar, kullotat ishin kufizuar dhe reduktuar dhe me kilometra zonë rurale të shkurreve kodrinore-malore ishin braktisur nga

urdhri dhe prania e ushtrisë serbo-sllave. E, kjo e vështirësoi tej mase jetën e fshatarëve të Gorozhupit, duke humbur shumicën e burimeve ekzistenciale të jetës së banorëve të fshatit.

TELAT GJEMBORË TMERRONIN...

Më i moshuari i fshatit, Mehmet Tana, në kohën kur e vizitua fshatin Gorozhup, tregon më së miri historikun e këtij fshati. Ai për revistën tonë, "Kosovarja", tha se atëbotë, për ta bërë edhe më të vështirë jetën e fshatarëve në të dy anët e kufirit, ndodhën shumë gjëra dramatike. "Së pari, u vendosën tela gjemborë në kufi dhe ata u bënë të pakalueshëm. Nja një kilometër e gjysmë nga shtëpia ime, e që është më e largëta në fshat, u ndërtua kazerma ushtarake dhe karakolli në kodër, prej nga vëzhgohej e tërë hapësira nga ana e Shqipërisë. Objektet ushtarake u ndërtuan në lagjen "Martinaj", pronarët e të cilit vend janë pikërisht mjeshtrit e gatimit të njohur sot në Prishtinë me emrin "Furra e Qerimit". Kemi vuajtur shumë sa nuk mund të shpjegohen të gjitha detajet. Këtu ka ndodhur aksioni për mbledhjen e pushkëve në vitin 1956, me çka u rëndua edhe më shumë jeta e fshatarëve të Gorozhupit. Kur filloi aksioni i armëve, porosia për ne u bë e qartë: Duhej ta braktisnim fshatin dhe të lenim hapësirë të lirë malore për forcat serbo-sllave. Duhej të iknim për të mos e parë lagjen "Pogaj" të Gorozhupit që mbeti në Shqipëri, e që ishin vëllezërit tanë hasjanë.

VRASJET PA PARALAJMËRIM...

Kishim pasur një histori, çdo gjë të për-bashkët. Por, me vënien e kufirit përmes Gorozhupit, çdo gjë u bë e huaj për ne. U pamundësua kalimi kah ta dhe këndej dhe kushdo që u kap në mes dy fshatrave u vra pa asnjë shpjegim. Edhe bagëti që vinte nga mali po të depërtonte në anën tjetër vritej mizorisht, sepse kjo zonë kufitare mori epitetin "Zonë ushtarake rreptësisht e ndaluar!". Po ashtu, duke shpjeguar detajet dhe ngjarjet e rënda në mes dy kufijve, Mehmet Tana, thotë: "Çdokush që kapej në mes dy kufijve vritej, ndërkohë që ne kishim miqësi me ta dhe ata me ne. Mbetëm të izoluar, duke mos e takuar më miku-mikun, fqinji-fqinjin dhe duke u parë nga largësia vetëm te kroi i fshatit. Aty mbushnim ujë kur e kishim orarin e caktuar në prani të ushtarakëve të të dy anëve kufitare.

Një numër i madh vrasjesh të banorëve të këtushëm dhe të të tjerëve që nuk i njihnim, bëheshin në kufi sa herë që i duhej pushtetit të bënte vrasje politike ose të montuara, apo sa herë i duhej ta ekzekutonte dikë që e konsideronte armik të shtetit.

I merrnin dhe i qonin te kufiri. I linin afër ndonjë torbë me gjëra, në mënyrë që të arsyetonin vrasjen kinse ka dashur ta kalojë kufirin ilegalisht.

SI U LIKUIDUA NË KUFI SALIH TEJECI?

Nga fshati ynë njihet rasti i Salih Tejedit, të cilin e kanë likuiduar në kufi. Ishte 45 vjeç. Thanë se e kishin zënë duke dalë në Shqipëri. Ne e dinim se kjo nuk ishte e vërtetë, por nuk guxonim të flisnim, sepse na priste e njëjta gjë edhe neve... Po në këtë kufi është ekzekutuar edhe Rrustem Martinaj, nga i cili sot janë familjet e furrave të njohura "Qerimi" në Prishtinë.

Ne jemi çliruar vetëm pas çlirimit të Kosovës, sepse shumëkush nuk e di se ç'është zullumi dhe si ishte të jetosh në kufi...

Prandaj, ne i jemi gëzuar çlirimit të Kosovës më shumë se kushdo tjetër".

KROI I LOTËVE...

Kroi që me shekuj i kishte ofruar banorët e Gorozhupit, u bë kroi i ndarjes, i lotëve... U bë edhe mollë sherri ndërmjet dy ushtrive të dy shteteve në kufirin ndërshqiptar, ku vëllai me vëllanë nuk guxonte të fliste, madje nuk guxonin as të përshëndeteshin...

Mejdiu, mbi 40 vjeç, tregon se si e mban mend këtë rrugë të përditshme kur me vëllanë më të madh bartnin ujë me gomar. "Ishte rrugë e vështirë dhe e bënim për-

ditë. Me ne ndodheshin ushtarët kufitarë edhe gjatë shkuarjes, por edhe gjatë kthimit", thotë Mejdiu.

Tutje ai tregon se si duhej t'i linin gomarët në lëndinë të hanin barë, teksa u vinte radha të merrnin ujë...

Kjo bëhej për të mbajtur rendin te kroi ku mund të shkonin vetëm dy nga dy.

Dhe, po të fliste kroi, do të tregonte çudira...

HALILI KURRË NUK IA GJETI VARRIN BABA MALIQIT

"Në ditën e mbylljes së kufirit, Maliq Morina kishte shkuar në treg në Prizren", tregon Halil Morina, i biri i Maliqit, e që e la "jetim" për së gjalli.

Halili tash është më i moshuari i Gorozhupit nga lagja "Pogaj".

Ai, duke treguar historinë e ndarjes së fshatit, thotë se kufiri e ndau me babanë.

Ai mbet në Prizren, e ky në fshat, në pjesën e Shqipërisë.

U rritë pa baba që nga mosha pesë vjeç.

"Babai mbet në Prizren, meqë kishte shkuar në pazar...

Po atë ditë mbyllet kufiri dhe ai mbetet atje...

Kurrë më nuk e kam parë babanë tim e as ai mua.

Ka vdekur dhe nuk ia di as varrin...

Për vdekjen e tij kemi mësuar nga një grua e fshatit Vlane. Te kroi u ka thënë grave që mbushnin ujë se kishte dëgjuar se kishte vdekur Maliq Morina", thotë Halili.

Sidoqoftë, historia e Gorozhupit është e dhimbshme...

Por, shyqyr Zotit, kjo tashmë i mbetet së kaluarës dhe sot endemi lirshëm këndej e andej kufirit...

S. Krivaça

Gratë tona në burgjet e dikurshme të Serbisë

Ajshe Gjonbalaj

*Me femrat shqiptare burgjet u mbushën në vitet 1981-1991.
Ato akuzoheshin si kundërrevolucionare, nacionaliste, separatiste...*

Në dhjetëvjetëshin 1981-1991 femrat shqiptare përjetuan pothuajse të gjitha format e dënimit dhe të diskriminimit. Sipas një studimi të Prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha, më 1982 u dënuan 7 gra; më 1983-4 veta; më 1984-4 veta; më 1985-6 veta; më 1986-9 veta; më 1987-3 veta; më 1988-9 veta; më 1989-4 veta dhe më 1990 u dënuan 6 veta.

Andaj, sipas statistikave, del se brenda 10 viteve të lartpërmendura u dënuan gjithsej 52 gra shqiptare.

E, njëra ndër to që mbajti burg të rëndë është Ajshe Gjonbalaj, nga Vuthaj, e burgosur politike e viteve 80, pjesëmarrëse e demonstratave më 1968 dhe 1981, ku edhe është dënua me burg 13 vjet, e që shtatë prej tyre i ka vuajtur në disa burgje, shumicën në burgun e Pozharevcit në Serbi.

KUSH ËSHTË AJSHE GJONBALAJ?

Ajshe Gjonbalaj është e lindur më 1 tetor 1948, në Vuthaj, në Mal të Zi. Shkollën fillore e ka kryer në Vuthaj, normalen në Pejë, kurse Shkollën e Lartë Pedagogjike

në Prishtinë, më 1971.

Ka punuar dy vjet në vendlindje, kurse 11 vjet në Shkollën fillore "Ganimete Tërbeshi" në Llukar, komuna e Prishtinës.

Ka qenë pjesëmarrëse e demonstratave të vitit 1968 në Pejë. Në Prishtinë mori pjesë në demonstratat e vitit 1981. E arrestuan më 23 mars 1984, në Prishtinë, në vendin e punës ku punonte, në shkollë, në Llukar. Dënimin me burg e mbajti nga 23 mars 1984 deri më 29 nëntor 1990.

Në një intervistë të mëhershme për Revistën tonë, "Kosovarja", ajo shprehet: "18 vetë të grupit tonë na kanë burgosur. Kryetar i grupit ka qenë Rifat Kafexholli. Grupi ishte shumë aktiv dhe i guximshëm, aq sa na quanin "bombaçët", grup që njiheshim si minues të Jugosllavisë!

Dy net burg të rëndë i kam mbajtur në Prishtinë, ditët tjera në Mitrovicë.

Të gjithëve na kanë rrahur shumë...

Pastaj, na shqiptuan dënimin në Prishtinë. Rifati u dënua me 20 vjet burg, unë me 13, kurse vëllai im, Beqiri, me 2 vjet, Nuhi Bunjaku me 15 vjet, Shaqir Ruhani me 15 vjet, Hazir Xhafolli me 12 vjet, Nazmi Krasniqi vdiq në qeli, në Pozharevc, në burgun qendror. Interesante: Nazmiu ishte i lindur

në burg nga nëna e burgosur dhe vdiq në burg si i burgosur!

Kur dola nga burgu mendova se ma ndërronin burgun. Lëshonin rrena të përditshme dhe nuk u besoja që lirohesha. Kam dal me rroba të burgut nga burgu i Pozharevcit. Më kishin amnistuar në festën e 29 nëntorit për Jugosllavi, më 1990. Ishte amnistia e fundit për lirime politike në atë shtet.

Në Pozharevc kam bërë burg qeli më qeli. Në një rast erdhi të na vizitonte Kryqi i Kuq dhe policja më tha se më kërkonte dikush për vizitë. Kisha dyshimin se vinin nga Beogradi t'më provokonin, meqë shpesh ndodhte kështu.

Kërkuan nga unë t'u tregoja se si më trajtonin në burg. U tregova në hollësi për të gjitha torturat...

Pasi kryen punë ata shkuan.

Për çudi, në fillim të atyre ditëve nuk më ndëshkuan për ato që i thashë. E, pas një muaji i nxorën do kushte që nuk mund t'i bëja, andaj 6 javë më dënuan të qëndroja në qeli të errët, duke fjetur në dysheme". Por, përjetime si Ajshe Gjonbalaj, pa dyshim, kanë pasur edhe të burgosurat tjera, ndoshta edhe më të rënda...



Pse rugovasit i shtrijnë këmbët kah mujnë?

Për vallen e Rugovës, që aludon në krahinën e Rugovës, një koleg yni, që ka vdekur vite më parë, tregonte një batutë: “A e dini pse rugovasit i shtrijnë këmbët andej-këndej? Sepse, e kanë ndotur aq shumë vendin sa më nuk kanë vend ku t’i qesin këmbët!”.

Ka 4 vjet që Kosova nuk e ka asnjë njohje të re. Madje, gjatë kësaj kohe disa shtete i kanë i tërhequr njohjet e tyre, e që politikanët tanë nuk e kanë pranuar asnjëherë! Por, këtë e ka theksuar vazhdimisht kancelaria britanike, cila ka bërë me dije se disa shtete i kanë tërhequr njohjet për Kosovën...

A thua, pse?

Sepse, paria jonë politike, që udhëheqë vendin, është bërë si vallja e Rugovës, që e ka ndotur aq shumë vendin sa më s’ka ku t’i qesin këmbët!

Paria jonë e ka shkatërruar shtetin ku duhej të jetojnë fëmijët tanë, nipërit dhe mbesat tona.

Andaj, sot Kosova është vend i injoruar nga bota, vend kundër të cilit janë kthyer edhe miqtë tanë, ata që kanë lobuar për

Kosovën me vite e vite...

E, se Kosova ka ardhur në këtë derexhe, tregon më së miri edhe rasti i fundit që disa shtete tona mike, si, bie fjala, Franca e Gjermania, janë kundër anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës!

MENTALITETI KOSOVAR: SHTETIN DUHET VJEDHUR!

Merrni me mend kompaninë publike “Vala 900” sa ka qenë profitabile!

Dhe, koha kur ka qenë ai profitabilitet ka pasur konkurrencë rivaliteti, që e ka bërë shteti. E, shteti kanë qenë Hashim Thaçi... E, ku është tash “Vala 900?”

Me të më nuk merret askush, sepse s’ka

më para, edhe pse e ka rrjepur popullin me tarifa të shtrenjta, ndërkohë që sot japin dorëheqje njerëzit që nuk e dinë as vetë pse janë aty, në menaxhim!

Dhe, shteti më nuk po e qan kokën për “Valën 900”, sepse më në të nuk ka para! Sot mundësi për hajni ka mbetur vetëm në dy sektorë të shtetit: Në tenderët e asfalteve dhe në KEDS! Aty janë bordet, aty janë njerëzit e kontratave që e kanë shkatërruar buxhetin e shtetit nga njerëzit që nuk kanë ego, sepse ata e kanë bindjen se shtetin duhet vjedhur!

Sidoqoftë, kohë më parë për korrupsion të madh në Kosovë doli me fakte edhe Departamenti Amerikan i Shtetit...

Kështu, pra, na e kanë kthyer shpinën edhe miqtë!

D.

Kosovari që jetoi në 3 shekuj!

Njeriu më i vjetër në Kosovë, Isuf Maloku, ishte nga fshati Jezerc i Ferizajt. Ishte i vetmi që ka jetuar në 3 shekuj! Ai e kishte bindjen e plotë se i kishte 124 vjet. Për dosjen e tij në zyrën e vendit nuk ka shënime. Ishte regjistruar te hoxha i regjimit të Turqisë, kur Kosova ishte nën sundimin e Perandorisë Osmane, por shënimet janë djegur në luftën e fundit.

Në kohën kur e vizituam në shtëpinë e tij në fshatin Jezerc të Ferizajt, në prill të vitit 2005, Isuf Maloku nuk kishte dëshirë të jetojë më gjatë, por një shekull e 24 vjet sa i kishte, i dukej sikur të jetë lindur dje!

Ai kurrë nuk ka pirë duhan dhe ka jetuar në vend malor, pranë "Kroit Akull" në Jezerc.

Është ushqyer me bylmet të bagëtive dhe me pemë e perime nga bahçja e

tij.

Mbi të gjitha, ai për jetëgjatësinë e tij thotë se ishte dhuratë e gruas, pasi ajo kurrë nuk e ka hidhëruar në jetë...

I lindur më 1881, njeriu më i vjetër në Kosovë, Isuf Maloku i mban mend ushtarët turq në vitin 1912, kur ata me ekspedita shkonin në bazën e tyre ushtarake te xhamia në Jezerc dhe aty i bënin pushkët "kupicë" në mes të oborrit.

Atëbotë Jezerci ishte një qendër domethënëse e rajonit, falë lumit të kthjellët që shkonte në Nerodime e Ferizaj, me shumë mullinj kualitativë, të cilët gravitoheshin nga agrarët e Ferizajt e deri në Prishtinë, si dhe nga Anamorava deri në Gjilan e Kaçanik, Suhareka e Malisheva, por edhe shumë vende të tjera.

Kujtesa e Isuf Malokut është më e kthjellët se e pesë djemve të tij, të ulur

në qilimat e odës së tij në Jezerc, në fillim të prillit të vitit 2005, kur ata, të ulur rreth tij, prej të cilëve më i vogli "sugari" 83 vjeç, e kontestojnë moshën e babait, duke i thënë se nuk i ka 124 vjet sa thotë ai.

Por, Isuf Maloku del me fakte dhe u thotë djemve:

"Në vitin 1912, kur u shpall Pavarësia e Shqipërisë, unë isha i rritur. Ushtarët e Turqisë atë vjet i patën ndërrua çizmet. Për herë të parë i patën do çizme të kafta prej lëkure dhe kalonin këtu pari e i bënin pushkët "kupica" në oborrin e xhamisë.

I mbaj mend si sot, e për atë edhe e di se i kam 124 vjet", thotë xha Isufi.

Ai ka jetuar 19 vjet në shekullin XIX, 100 vjet në shekullin XX dhe pesë vjet (kur është bërë biseda) në shekullin XXI.

Isuf Maloku i mban mend mirë ushtarët e Turqisë, pastaj Serbinë e parë më 1912, Serbinë e dytë më 1918, ardhjen e bullgarëve më 1941, aksionin e armëve të Serbisë më 1956 dhe të gjitha ngjarjet që janë zhvilluar mbi popullin tonë për kaq shumë vite.

SHOKËT E FËMIJËRISË I KANË VDEKUR QËMOTI!

I lindur para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit,

Isuf Maloku më nuk ka shokë të jetës. I kanë vdekur me dhjetëra vjet më herët.

Nuk është i qasshëm në çdo lloj muhabeti me brezat e rinj. E ka zor ta gjej dikë me të cilin mund t'i kujtojë kohët e tij të vështira.

Ai edhe sot ka kujtesë të fortë. I kujton emrat e para 100 e më shumë vjetësh. Plaku, që jeton në Jezerc, aty ku verë e dimër gurgullon ujëvara mbi shtëpinë e tij dhe lumi përgjatë fshatit, në një peizazh të papërshkrueshëm atraksioni, nuk e do jetën në qytet, se zhurma ia prish qetësinë shpirtërore...

Me të përfunduar lufta e fundit në Kosovë, e cila në bjeshkët e Jezercit kishte filluar më 1998, pesë djemtë e tij zbritën poshtë për t'i ndërtuar shtëpitë, por Isufi nuk u pajtua me atë vendim.

Ai kishte kërkuar që të ndërtohej shtëpia e tij, mbi themelet e shtëpisë së djegur në mal, mu te Kroj në oborrin e tij.

Plaku me numër të këpucëve 46, ka

jetuar larg duhanit, me ujin e natyrës, ajrin e lartësive malore dhe me pemë e bylmet të bagëtisë së vet, por shpesh edhe me arinj, që janë banorë të malit që lidhet me "Sharrin".

Për 124 vjet jetë, ai kurrë nuk ka qenë i sëmurë dhe mjekun e di vetëm përmes fjalëve që identifikon një njeri me mantel të bardhë.

"Nuk jam kanë i lig kurrë, veç tash më ka lëshu takati, se kam ba shumë vjet", thotë ai.

Njerëzit e moshës sime kanë vdek dhe janë harru moti, bile unë jam mbet tepër", thotë ai.

ÇKA MBAN MEND NGA KOHA E TURQISË?

Isuf Maloku i mban mend shumë regjime dhe ushtri, shumë luftëra dhe masakra mbi shqiptarët e Kosovës.

"Kur o hjekë Turkia prej këtu, jam kanë i madh. E mbaj mend mirë ushtrinë e turkut, sepse takoheshim me ta kur shkonim në mejtep te Mulla Uka i Ferizajt.

Kur kam shkua në Ferizaj, çojsha dru me kali. Ferizaj a kanë vend i vogël.

S'di sa shtëpia i ka pas, por vëllai jem, Osmani, që ka jetuar 100 vjet, më thoshte se Ferizajn e mbante mend me katër shpija.

E, Jezerci atëherë i ka pas 300 shtëpi. Këndej pari kanë kalu, besa edhe kanë bujt Isa Begi, e shumë tjerë që i njeh historia. Në katundin tonë ka bujt edhe Bajram Begi me shumë komita të tjerë.

Jezerci nuk asht ba i njohun vetëm me luftën e fundit, por edhe me shumë lufta tjera, e me shumë histori që i ka ba për popullin dhe Kosovën.

Ushtria e turkut i ka pas do kapuçë të leshtë të zi, çizme deri nën gju, të mira e të forta prej safjani.

Nuk e ngucshin kënd, se nuk janë kanë sikur regjimet tjera që i thernin burrat me thika.

I mbaj mend kur ecshin nga 8-9 vetë nëpër katund. Nuk bajshin zullum", tregon ai.

PUSHTIMI I KOSOVËS NGA SERBIA E PARË

Largimi i Turqisë, më 1912, ka rezultuar me ardhjen e Serbisë së parë, e për këtë pushtim, Isuf Maloku, thotë:

"E mbaj mend kur iku turku prej

këtu. E lëshoi vendin pa luftë dhe menjëherë erdhi Serbia e parë. Shkau mori shumë shqiptarë dhe i çoi në Nerodime. E morën edhe Haxhi Idrizin. Kush ka mund me ikë e me u largu nga shtëpia ka shpëtu, e kush o nxanë në shtëpi e kanë pre shkiyet në Nerodime.

Serbia e parë ka ba shumë zullum...

Ajo kohë zgjati tre vjet, e pas asaj kohe erdhi bugari dhe e përzuni Serbinë me luftë".

LUFTA TE "GURRA E KADRISE"

Duke i kujtuar ngjarjet e kohës, njeriu më i vjetër në Kosovë, Isuf Maloku, thotë:

"Kur erdhi bugari me e përzanë Serbinë, u ba luftë te "Gurra e Kadrisë" dhe e ndjeku shkau. Lufta mes shkieve dhe bugarëve u bë ndërmjet Jezercit e Budakovës.

Aty hupi Serbia dhe ia lëshoi bugarit vendin për tre vjet.

E, kur u hjek bugari, ishte viti 1918. Erdhi Serbia e dytë, por ajo e përdori mashtrimin kundër shqiptarëve.

"Kush ik prej shpive, nuk ka me pas kurrë probleme!", thoshin serbët.

Në atë kohë, më kujtohet shumë mirë aksioni i mbledhjes së armëve. Një herë i mashtruan burrat me u kthye në shpija dhe kur u kthyen, i merrshin dhe i qojshin në Nerodime. I kanë rreh e i kanë vra se u lypshin pushkë.

Erdhën shumë shkije në Jezerc në qat kohë dhe me mjeshtri e propagandë i larguan burrat e këtuhit për në Shqipëri".

JETA NË MULLI

Isuf Maloku, si i ri, e ka kaluar jetën në mullirin e familjes, duke bluar grurë e misër. Jezerci atëherë ka qenë vendi më i preferuar për të bluar.

"Kemi pas gjithmonë mulli", thotë plaku dhe shton se ka qenë privilegj të kesh mulli në Jezerc.

Mulliri ku punonte Isufi ishte në mes dy lumenjve. Njerëzit i kanë kaluar aty edhe nga 1 javë, duke pritur t'u vjen radha të bluajnë.

"Erdh njani me blu. Dhe, taman hyni mrena dhe piu ujë, diq në mulli.

U desh me e kthye xhenazen në shtëpinë e tij...", tregon Isuf Maloku në fund të bisedës sonë.

Jetë me mistere

Mevlydja e Ferizajt i "hëngri" dy vëllezër!

Pas vdekjes së burrit të parë, me të cilin pat dy djem, ajo filloi t'i "hante" burrat një nga një...

Pas vdekjes së burrit të parë, familja e saj Mevlyden e detyruan të kthehej për vëllanë e burrit, sepse martesat në atë kohë ishin të kushtueshme, e në radhë të parë të mos mbesnin fëmijët jetim edhe pa nënë.

Kur u kthye për kunatin, e që ishte më i ri se burri që e kishte pasur, nuk bënë dasmë, sepse plaga për vdekjen e burrit të parë ende ishte e njomë, kishin kaluar vetëm tre muaj që ai kishte vdekur nga një sëmundje e shpejtë.

Mevlydja ishte e bukur, por edhe e zonja, andaj çdo kush kishte lakmi ta kishte në shtëpinë e vet.

Por, e keqja e saj ishte se sytë i kishte të gjelbër dhe keqbërësit në atë kohë thoshin se ngjyra e syve të saj ishte e ngjashme me ngjyrën e syve të gjarpurit dhe njëjtë si gjarpri do i helmonte burrat...

Dhe, u bë si u bë, Mevlydja tashmë ishte nuse e vëllait të burrit të parë.

Por, që nga nata e parë që fjeti me të, burri i dytë i saj nuk gjeti rehati në shpirt, sepse duhej të shëroheshin plagët e vëllait të vdekur dhe duhej që kjo martesë të kuptohej si domosdoshmëri.

Sidoqoftë, një natë asaj i ishte shfaqur në ëndërr ish-burri i saj, madje me kokë gjarpri. E, kjo i dha Mevlydes ta kuptojë se kishte hyrë në gjynah që ishte kthyer për vëllanë e tij.

Dhe, që nga ajo natë burri i saj u sëmua dhe e dërguan për mjekim në spitalin e Prishtinës.

Mjekët bënë çmos ta shëronin, por shëndeti i tij ditë e më shumë keqësohej.

Një muaj më vonë ai vdiq në gjumë.

Vdekja e burrit të dytë të Mevlydes në familje u përcoll me shumë lot e mërzë.

E, për të mos e humbur edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes, më nuk donin që

ajo të kthej në atë familje. Ia ndalën fëmijët dhe e përcollën për në familjen e saj.

SI U MARTUA MEVLYDJA PËR SË TRETI HERË?

Një burrë që ishte vejan nga një lagje e Ferizajt troket në familjen e Mevlydes dhe u thotë se është i gatshëm të martohej me të.

Vëllezërit e saj e dhanë menjëherë, jo se u ishte mërzitur motra, por donin ta

lironin nga vuajtjet e njëpasnjëshme që e përcillnin.

Por, edhe pse në fillim çdo gjë shkoi mirë, pas 6 muajsh, burri i saj, teksa kthehej nga puna, papritmas gjenden i vdekur në rrugë.

E, Mevlydes s'i mbeti tjetër pos të kthehet sërish te familja e saj dhe u betua para vëllezërve se më nuk do të martohej me askënd, por do jetoj me kujtimin për dy djemtë e saj që i kishte me burrin e parë.

D. H.





ALLURE BEAUTY JU KTHEN **20 VITE** pas në kohë!



Pa dhimbje! Pa kirurgji!
Allure Beauty



Në komunikimin e përditshëm me njëri-tjetrin, njëra ndër frazat më të shpeshta që ne përdorim është “Në fillim shëndeti pastaj të tjerat...”, por, në realitet, fatkeqësisht, kjo frazë mbetet vetëm deklaram.

Edhe pse shkenca mbi shëndetin ka bërë evolucion të madh në parandalimin e sëmundjeve dhe zgjatjes së jetës, papë ajo çka mbetet vendimtare për shëndetin personal është strategjia e vet kujdesit. Edhe pse shëndeti është pasuria më e madhe që posedojmë, rëndësinë e tij shumica nga ne e vlerësojmë në ato momente kur trupi ynë ballafaqohet me ndonjë çrregullim ose reagim emocional, që mund të jetë edhe adekuat për momentin, siç është frika.

SI LINDË FRIKA?

Njeriu kur vjen në këtë botë sjell më vete shumë instinkte, që zanafilla e tyre buron që nga paraardhësit tanë, e ku njëra ndër to është edhe frika, e cila në një mënyrë ka qenë dhe është shumë domethënëse dhe e rëndësishme për mbijetesën e Homosapiens (njeriut).

Frika dhe stresi mund të menaxhohen

Frika është e dobishme dhe e nevojshme si sinjal alarmi për të paralajmëruar organizmin tonë nga rreziku (edhe pse rreziku ndonjëherë mund të jetë imagjinar) dhe drejton vëmendjen në përgatitjen e trupit për një reagim të shpejtë ndaj rrezikut, që do të thotë se frika në një masë të caktuar është krejt normale.

Në psikologji bëhet dallimi i qartë në mes frikës si reagim (State anxiety) dhe frikës si karakteristikë (Trait anxiety).

Gjatë përjetimit të frikës si emocion, e cila rrjedh nga një rrezik aktual dhe objektiv dhe që është kaluese, frika “trait anxiety” dërgon drejt momenteve që situatat të përjetohen të rrezikshme edhe pa ndonjë shkak.

Në një mënyrë në të gjithë kemi frikë, mirëpo të edukuar me bindjet se duhet të jemi të fortë dhe se nuk duhet të kemi frikë, sepse atë e shohim si dobësi dhe se vetëm ata që janë të dobët kanë frikë.

KUR MBYLLEMI NË VETVETE?

Gjatë procesit të jetës, kur ballafaqohemi me frikën, ne kemi turp dhe krijojmë ndjenja faji, duke u mbyllur në vetvete me mendimet se me ne nuk është diçka në rregull dhe se nuk jemi “normal”. Ne luftojmë me veten tonë, duke u munduar medoemos t’i shmangim këto ndjenja, që në radhë të parë janë tonat dhe ne i kemi krijuar. Këto ndjenja kërkojnë pranimin tënd që ti ndiesh e jo t’i luftosh me turp, faj, lot e dhembje, e në shumicën e rasteve (fatkeqësisht një numër shumë i madh i lufton fshehurazi) me substanca farmaceutike. Të gjitha këto janë kontraproduktive për shëndetin tonë fizik dhe mendor dhe krijojnë një stres edhe më të madh, e që mund të bëhet kronik me pasoja të pa

imagjinuara për sistemin tonë emocional dhe nervor.

Duhet ta kemi parasysh se stresi i tepërt dhe me kohëzgjatje stimulon rritjen e frikës, sidomos kur është i shoqëruar dhe ndërlidhur me ndjenja negative dhe tension emocional.

Kjo barrë e përhershme me kërkesa dhe pritshmëri në nivele të larta mund të jenë faktorë që mund të manipulojnë dhe kontrollojnë jetën tonë.

Edhe pse, sipas studimeve, një numër i madh i vdekjeve lidhen drejtpërsëdrejti me sjelljen e njeriut ndaj mirëqenies së vet, ne megjithatë shumë pak i japim vëmendje gjendjes sonë emocionale, e bile në një fare mënyrë është bërë trend të referohesh para mjedisit që ke shumë stres dhe se sa më shumë stres që kemi mburremi dhe mendojmë se me të vërtetë jemi të rëndësishëm. Duke pasur mendimet e tilla në këtë mënyrë, ne klasifikohemi në shoqëri si personalitet i përkryer modern, i cili në realitet është i çekuilibruar nga frika dhe stresi, si dhe nga dëshira e fortë për t’u përshtatur dhe pranuar nga ana sociale.

ÇKA E ÇRREGULLON SHËNDETIN MENDOR?

Përmasat dhe shabllonet për të cilat ne mendojmë se janë të domosdoshme që t’i takosh një shoqërie “normale”, po shkaktojnë tension dhe stres shumë të madh, i cili është një ndër faktorët kryesor në çrregullimin e shëndetit mendor.

Që çrregullimet emocionale të parapririn nga frika e cila nuk menaxhohet mirë të mos kalojnë në çrregullime psikologjike, këshillimet psikologjike përqendrohen në mënyrën se si bashkëveprojnë trupi dhe mendja në sjelljen e njeriut.

Të gjithë faktorët stimules që ndërlidhen dhe ndihmojnë në rritjen e frikës kërkojnë ndryshim dhe reflektim të individit, por se ky ndryshim ka mundësi të përjetohet në të njëjtën kohë edhe si stresues.

Se në çfarë përmasash sjellja njerëzore dhe psikologjia e ndryshimit përcaktohet nga proceset e brendshme, e në radhë të parë nga truri ynë, është me rëndësi të jemi të informuar se çfarë roli luan Amygdala për frikën tonë, si dhe çfarë gjuhe flasin neuronet tona ose më mirë të themi “Mesenxheret” tanë në relacionin truri-trup kur merret një vendim për ndryshimin e sjelljes dhe vetive tona.

Shkëndije Pacolli



**PRAXIS FÜR
PSYCHOLOGISCHE
BERATUNG**
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6
56422 Wirges

BOOM

Dubai,
destinacioni
ku disa
VIP-a tanë
i shijuan
pushimet
këtë pranverë

Shqipe Dumani -
shqiptarja e suksesshme
në Zvicër që i bënë
femrat të shkëlqejnë

Shqipe Dumani është artiste e fushës së bukurisë dhe estetikës, e talentuar, e suksesshme dhe e mrekullueshme në atë që bën. Me origjinë nga Drini i Bardhë i Pejës, e lindur dhe e rritur në Baden AG të Zvicrës, 31-vjeçarja sot është një nga shqiptaret e suksesshme të Diasporës. Viteve të fundit është plotësisht pjesë e fushës së bukurisë dhe ka sallonin e saj të njohur "Beauty by Shqipe", që gjendet në Dietikon të Cyrihut. Në këtë sallon, ku femrat ndihen të mirëpritura gjithmonë, punon një staf i vogël, por profesional dhe klientët ndihen përherë si në shtëpinë e tyre.



Shqipe Dumani - shqiptarja e suksesshme në Zvicër që i bënë femrat të shkëlqejnë



Shqipe, do të donim të të njihnim më mirë?

- Jam Shqipe Dumani, 31 vjeçe, e lindur dhe e rritur në Baden AG të Zvicrës. Prejardhjen e kam nga Peja, nga Drini i Bardhë.

Si të përshkruajnë ata që të njohin?

- E hapur, simpatike, familjare. Ata që më njohin besojnë në qëllimet dhe synimet e mia.

Punon në fushën e bukurisë dhe estetikës. Na fol pak për profesionin tënd?

- Punoj qe pothuajse pesë vjet. Është profesion që kërkohet shumë viteve të fundit. Është një fushë e madhe që ofron shumë tretmanë të ndryshëm. Kam specializuar në laser për heqjen e qimeve.

Biznesi yt është tashmë i suksesshëm. Si e arrite?

- Isha edhe unë punëtoresh para se të hapja biznesin tim dhe e analizova se kërkesa e klientëve ishte e madhe të trajtohen nga unë. Andaj, më erdhi ideja që të hapi biznesin tim. Mendoj se karakteri im i hapur dhe mënyra se si komunikoj më ka sjellë deri ku jam sot.

Çfarë shërbimesh ofroni dhe çka ju bënë ndryshe nga qendrat tjera të bukurisë?

- Ne punojmë me laser (heqjen e qimeve), bëjmë zbardhim të dhëmbëve dhe në të ardhmen e afërt do të bëjmë trajtime profesionale për fytyrë.

Po ti, vetë, cilin shërbim e kryen më me pasion?

- Me pasion dhe përkushtim e bëj laserin. E dua, sepse kam specializuar në këtë drejtim dhe më pëlqen që rezultatet mund të shihen menjëherë. Gjithashtu, ndihem tejet mirë kur i shoh klientet të lumtura.

Cila është formula e suksesit në këtë punë, biznes?

- Kur klientët shohin sukses në tretmanë dhe, pa dyshim, mikpritja luan rol të madh.

Ne jemi sallon miqësor dhe i njohim klientët tanë, sepse na vizitojnë pothuajse çdo muaj.

Sa sfiduese është të jesh grua dhe të jesh e suksesshme në një vend të huaj?

- Mendoj se nuk është e lehtë si nënë të kesh një biznes dhe familje e shtëpi. Por, jemi femra dhe e kalojmë çdo sfidë. E, sa për vend të huaj, këtu, në Zvicër, mund t'ia dalësh, sepse shteti na mbështet shumë.

Ke menduar ndonjëherë të hapësh diçka edhe në Kosovë?

- E kam menduar shpeshherë. Por, për t'u bërë kjo, do dëshiroja të jem edhe unë atje, në sallon.

Mendoj se në të ardhmen do ta realizoj edhe këtë.

Cila është jeta jote jashtë profesionit?

- Jeta ime jashtë profesionit sillet rreth të qenit bashkëshorte e nënë e mirë dhe e përkushtuar.

Kam punuar shumë dhe punoj akoma, ndërkaq në atë pak kohë të lirë që më mbetet mundohem të jem plotësisht me familjen dhe fëmijët e mi.

Ndonjë talent të fshehur?

- Po, patjetër, por kam shumë...

Kuzhina tradicionale apo ajo moderne?

- I preferoj të dyja. E dua kuzhinën dhe jam një kuzhiniere e mirë...

Kujt i thua faleminderit?

- U them familjes dhe shoqërisë, sepse pa ta s'do të isha ku jam sot.

N. Neziri



Dubai, destinacioni ku disa VIP-a tanë i shijuan pushimet këtë pranverë

Udhëtimet në sezonin pranveror janë shumë të pëlqyera për shumë figura tona publike. E, për të marrë energji për sezonin veror që i pret ata, zgjedhën vendet e nxehta. Andaj, Dubai është një nga vendet që ua rrëmbeu zemrat disa personazheve publike...



ARBANA OSMANI

Arbana zgjodhi Dubain të kalojë ditë të paharrueshme me familjen e saj. Me të ishin dhe vëllai i saj me familje.

GRESA HOTI

Modelja Gresa Hoti, së bashku me familjen e saj, pushimet zgjedhën t'i kalojnë në Dubai. Vizita e vendeve turistike atje bëri që Gresa të nxjerrë poza shumë artistike.





NORA ISTREFI

Nora Istrefi me vajzën e saj zgjodhën Dubain për pushim pranveror. Të dyja duket se i shijuan pushimet mirë, meqë publikuan pamje vazhdimisht.

KEJVINA KTHELLA

Kejvina zgjodhi Dubain për të kaluar kohë relaksuese. Nuk munguan pozat provokuese që morën gjithë vëmendjen e rrjetit.



JORI DELLI

Jori u bëri prindërve dhuratë biletat për të udhëtuar në Dubai. Andaj, nuk munguan pozat e shumta nga bukuritë që ofron Dubai.

Edona Vllasaliu-Bajoku

Pse Shaqir Cërvadiku është i veçantë?

Këngëtari i këngës “S’kam kujtu se m’gjen pranvera”, Shaqir Cërvadiku, u lind në Poglek të Drenasit. Shkollën fillore dhe të mesmen i kreu në Drenas, ndërsa studimet në Prishtinë, Dega BAT. Ka punuar në shkollën e mesme në Drenas, kurse tash jeton në Belgjikë.

BABAI I TIJ 50 VJET ME KËNGË

Me këngë ka filluar të merret që i vogël. Prirjen e fitoi nga babai, Halil Cërvadiku, që ishte ndër rapsodët e mirënjohur në

Drenicë dhe më gjerë. Babai i tij, Halili, në duet me vëllanë e tij, Hysen Cërvadikun, 50 vjet e këndoi dhe e kultivoi këngën rapsodike.

Shaqiri pat fatin që i vogël t’i dëgjojë legjendat e folklorit e të këngës shqipe, duke kënduar në odën e babait të tij, Salih e Feriz Krasniqi, Rizah Bllaca, Qamili i Vogël, Tahir Drenica, Hashim Shala, Augustin Ukaj, Bajrush Doda, Bijtë e Sefës, e shumë të tjerë.

Dhe, duke i dëgjuar këngëtarët e mëdhenj, ai u mishërua dhe u dashurua në këngën, për të vazhduar deri në ditët e sotme.

NISI ME BABË E U AFIRMUA NË ANSAMBLIN “SHOTË GALICA”

Fillimisht me babë këndoi në dasma e gazmende, pastaj më 1977 u angazhua në Ansamblin “Shotë Galica”, ku dhe arriti afirmimin e plotë si këngëtar. Me ansambël ka marrë pjesë në qindra koncerte dhe

kanë bërë incizime të shumta në radio e televizion.

Në vitet 80 arriti afirmimin e plotë të publiku. Në ato vite disa këngë të tij u bënë hite, si, bie fjala, “Moj e mira bregut t’Cemit”, “Moj e mira nga Gjakova” etj.

Pastaj, e vazhdoi aktivitetin muzikor në ansamblin “Bajram Curri” të Prishtinës, me të cilin, po ashtu, patën shumë koncerte në Kosovë dhe Diasporë.

Që nga vitet 90 Shaqiri këndon si këngëtar i pavarur. Ka edituar deri më tani 23 albume dhe 4 albume me këngëtarë të ndryshëm dhe tri videokaseta.

Këngët më të dëgjuara të tij ishin dhe mbetën: “S’kam kujtu se m’gjen pranvera”, “Shkova kah nuk shkova”, “Moj e mira bregut t’Cemit”, “Moj e mira nga Gjakova”, “Shqipërinë e dua se jam shqiptar”, “Nuk është jeta 1000 vjet”, “Një letër m’ka ardh”, “Unë jetoj për ata sy”, e shumë të tjera.

Tekstet e këngëve i bën vetë, por ka këngë me tekste edhe të Sali Manit, Faruk Tasholli, Fatmir Mujës etj.

E, pse Shaqir Cërvadiku është gjithmonë aktual, flasin më së miri këngët e tij...



EXPECT THE UNEXPECTED



+355 69 604 1000



info@marinabay.al



marinabay.al

A jemi në udhën e Zotit?

Edhe mes të rinjsh ka të atillë që janë tradicional dhe modern, bile skajshmërisht tradicional ose e kundërta, skajshmërisht modern. Ata të traditave thonë se po teprohet me modernitetet dhe se kjo nuk i bën mirë vendit dhe shoqërisë sonë, ndërkaq modernët janë të mendimit se tradicionales “i ka dalë boja”.

FESTIM GËRGURI: NUK E DIMË QARTË Ç'ËSHTË MODERNIZMI

- Tiparet dhe shprehitë tradicionale janë ende të përfshira në gjeneratën tonë. Por, vërehet një modernitet i imponuar ndonjëherë...

Unë më shumë anoj kah modernia. Ndërsa, mënyra e të menduarit të shoqërisë te ne druaj të jetë më shumë tradicionale se që duhet.

Sidoqoftë, veprimet dhe pretendimet gjithsesi çojnë dukshëm kah modernizmi. Ekzistojnë paqartësi dhe jo definim i qartë i modernizmit në vendin tonë. Prandaj, jo rrallë shohim veprime që janë më vulgare e që konsiderohen moderne!

AJETE SHUKRIU: NGA TRADICIONAL JEMI BËRË SHUMË MODERN

- Edhe pse ne, si shoqëri, po ndryshojmë, nga një shoqëri thellësisht tradicionale po transformohemi në një shoqëri moderne.

Andaj, mendoj se shpeshherë po bëhemi tepër modern, duke i harruar vlerat dhe elementet e tjera tradicionale, të cilat na kanë mundësuar ekzistencën si komb. Sidoqoftë, gjërat tradicionale, të cilat janë pozitive, nuk duhet t'i lëmë pas dore, duke i harruar, por duhet t'i mbajmë dhe t'i ruajmë me fanatizëm, meqë disa prej tyre, bie fjala, muzika burimore shqipe, janë pasuri kombëtare.

ARTA MAHMUTI: TË MOS I KOPJOJMË TË TJERËT!

- Edhe pse jam e re, jam me tradicionalen. Kemi tradita të pasura si kulturë, andaj kam arsye të mirë të jem me traditat. Si shoqëri, mendoj se shumica jemi me tradicionalen, e ata që shkojnë kah modernia e tepruar, më duket se gjithmonë e kopjojnë dikë, pra nuk janë vetja. Mirëpo, sot nuk dihet se çfarë quhet moderne, duke parë se ata që sillen poshtë e lart e pa punë janë më “IN”, janë në hap me modernen, e kjo është për keqardhje.

E, ky teprim vërehet edhe në klipet e shumë këngëtarëve...

VERA BYLYKBASHI: ANOJMË KA MODERNIA

- Ka raste të tradicionalitetit, por kryesisht dominon ajo moderne. Andaj, mendoj se edhe shoqëria jonë në përqindje pak më të madhe anon kah modernia, por nuk është se është shuar apo po shuhet tradicionaliteti.

Nganjëherë shoqëria jonë po e “befason” edhe modernitetin me modernitet. Shohim dita-ditës “modernitet” të tepruar, shpeshherë edhe me raste ekstreme. Sidoqoftë, të jesh modern nuk do të thotë se duhet të dalësh jashtë rrugës së Zotit!

PËR FUND

Mendimet e të anketuarve në temën që e trajtuam janë të ndryshme. Por, shumë afër mendsh është mendimi i të anketuarës Vera Bylykbashi se të jesh modern nuk do të thotë se duhet të dalësh jashtë rrugës së Zotit!

Diturie Haxhaj

Askush s'është më e bukur se Ajo!

Kur e kishte shikuar për herë të parë kah po i ndërronte hapat, kishte pasur përshtypjen se para tij po defilonte një manekine, e cila ecte në sflatë mode.

Ecja e saj karakteristike aq shumë ia kishte tërhequr vëmendjen dhe aq shumë i kishte lënë përshtypje, sa që, nga ai moment, kishte filluar ta humbë qetësinë e shpirtit, e të ëndërronte veten e tij, të shndërruar në një qilin të shtruar, mbi të cilin do të shkelte këmba e saj...

KËMBËT E SAJ TË BUKURA

Zeshkënia me ecjen e saj karakteristike jo vetëm që e kishte joshur, por edhe e kishte çmendur me këmbët e saj të bukura.

Ato ishin magnet që tërhiqnin jo vetëm shikimin, por edhe tërë qenien e tij dhe e shpërqendronin të tërën. Madje, ato këmbë të bukura të saj ishin bërë pjesë e pandarë edhe e ëndrrave të tij, që i shfaqeshin posa fillonte të dremitej. Ëndrrat ishin të vetmet bashkëbiseduese me të, sepse vetëm me to guxonte të komunikonte, e vetëm atyre mund t'ua tregonte fshehtësinë.

Atyre e askujt tjetër ua shprehte ndjenjat që ushqente ndaj zeshkanes, e vetëm ato mund t'i flisnin për këmbët e bukura të saj.

Madje, ato i dëftonin se kah e bartnin ato këmbë gjatë ditës, ku i shtrinte gjatë natës, madje edhe ku i freskonte e ku i depilonte ato...

Nuk i lejohej në asnjë mënyrë të fliste me asnjë njeri rreth takimeve aq të pakta që i kishte me zeshkanen. Madje, as emrin e saj nuk i lejohej ta përmendte në prani të tjerëve.

Dhe, meqë i dukej se po eksplodonte nga bukuria, e quante "bombastikë", sepse ajo vërtet ishte si lëndë shpërthyes, si granatë që kur shpërthen dridh tokën.

BUZËT QERSHI...

Ndonëse granatonte me shkëndijat që dilnin nga shikimi i saj, ata sy të bukur i kishte më të ëmbël se rrushi i Rahovecit. Meqë kishte shikim të ëmbël, kjo edhe e kishte shtyrë të mendonte se puthjen e parë t'ia dhuronte syve të saj magjepsë. Por, ndjenjat e kishin tradhtuar, sepse atë puthje ua kishte dhuruar buzëve të saj të ëmbla si qershi Dukagjini. Madje, puthjen e parë në buzët e ëmbla ia kishte dhuruar mu pranë bregut të Drinit, aty ku rriten qershitë e ku madhështore paraq-

iten pamjet përreth lumit, që kishin çarë bregoren përmes për të krijuar legjendën e Urës së Shenjtë.

Dhe, teksa dashuria ndaj zeshkanes sapo merrte hov e po zhvillohej, papritmas po shembej e shkatërrohej, sepse po përshkohej nga një rrymë e ftohtë që po e rrëronte. Kjo po i ndodhte, sepse në shumë raste, mu atëherë kur vullkani që po shpërthente e po nxirrte nga brendia llavën përvëluese të dashurisë, vinte një valë e ftohtë sikur të dilte nga thellësia e ftohtë e Drinit, për ta ftohur, për ta shuar, madje edhe për ta ngrirë atë zjarr vullkanik që kishte filluar.

E, ftohja akull që shfaqej kohë pas kohe nga ana e zeshkanes ishte e çuditshme...

TAKIMI QË NUK U BË...

Ai e donte, e ëndërronte, e dashuronte, andaj kishte dëshirë edhe ta shijonte. Si ta realizonte një takim të tillë ku do t'ia shijonte buzët, sytë, flokët, shpatullat, gjoksin, këmbët dhe gjithë trupin e saj të bukur si margaritar?

P. K.

A kanë shqiptarët Romeo e Zhulietë?

Në qytetin e bukur të Elbasanit, në verilindje të tij, ndodhet një majë mali që quhet “Mali i Vashës”. Ç’thotë legjenda për të? Pse e ka marrë këtë emër?



Mali i Vashës

Në fakt, sot është vështirë të ndahet kufiri i legjendës me të vërtetën, por, si gjithmonë, rastet kthehen në legjenda kur kalojnë shekuj me radhë. “Mali i Vashës” mbetet simbol i një dashurie të zjarrtë. Pse e ka marrë këtë emër? Cila është legjenda e këtij mali? Çfarë fshehin fshatarët e Polisit rreth kësaj historie?

DJALI I VOBEKTË, VAJZA E BIJA E NJË TË PASURI...

Legjenda e “Malit të Vashës” tregohet nga një plak i moçëm në fshatin Polis të Elbasanit: “Dy të rinj të dashuruar pengoheshin ta kurorëzonin dashurinë, se djali ishte i vobektë, kurse vajza ishte e bija e një të pasuri.

Të dy i vuanin në heshtje pasojat e dashurisë dhe nuk shihnin asnjë rrugë bashkimi veç vetëvrasjes. Por, pleqtë e fshatit vendosën t’u vinin në ndihmë. Ishte vendosur që, sipas kërkesës së babait të vajzës, djaloshi duhej ta mbante në krahë të dashurën që nga fillimi i malit e deri në maje pa u

ndalur fare...

Kushti pranohet menjëherë nga i riu, që ishte i gatshëm për çdo sakrificë.

Ndërkaq, pleqtë e fshatit Polis u mblodhën për të ndjekur nga afër zbatimin e kushtit, pas të cilit do të caktohej edhe dita e dasmës së të rinjve.

Në fillim të asaj ngjitjeje djali fluturonte, por nuk vazhdoi gjatë. Pleqtë shihnin me shqetësim se si hap pas hapi djalë po e linte forca dhe e nxisnin nga poshtë: “Edhe pak, edhe pak, gati arrite!”. Sidoqoftë, djali arriti në maje të malit, por nga lodhja e madhe zemra i pushoi së rrahuri.

VAJZA U HODH NGA 700 METRA LARTËSI!

Dhe, për t’i qëndruar besnike kësaj dashurie me sakrificë, vajza nuk pranoi tjetër fat, veç vdekjes së lumtur dhe një dashurie të përjetshme. Kështu, vasha u hodh nga maja e thepisur e malit 700 metra të lartë dhe ra në greminë... Kështu, edhe përfundoi ajo dashuri e madhe e pakurorëzuar, por e mbe-tur deri në përjetësi, si një ndjenjë e pavdekshme.

1st tourist
CAMPING



Adresa: Shtoj, Ulqin

www.touristcamping.me

Tel: +38269336233

 /giovanniscampingresort



Giovanni's Beach
COPACABANA



Adresa: Shtoj, Ulqin

www.touristcamping.me

Tel: +38269825858

 /giovannis_beach_montenegro

Edhe kjo po ndodhke...

E martuar qe dy vjet dhe ende e virgjër!

*Jam Dashuria, nga Rahoveci, 33 vjeçe. Kam pasur të dashur,
por nuk ishte kështet të martohesha dhe lidhjet përfundonin shpejt.
Por, njohja me Rexhën, nga Belgjika, i ndryshoi gjërat...*

Me Rexhën, nga Belgjika, më njohu kushëriri im, i cili ndodhet në Gjermani. Ma dha numrin e tij të telefonit dhe biseda jonë e parë zgjati hiç më pak se një orë. Folëm e folëm derisa edhe u lodhëm... Dhe, si përfundim, e përmbyllëm bisedën që të dëgjoheshim edhe ditëve të tjera. Por, kaloi një javë dhe më as kushëriri im e as Rexha nuk më telefonuan. Mendova se kishte qenë lojë dhe asgjë më shumë... E, mu në kohën kur mendova se s'kishte gjë nga ajo punë, në telefonin tim erdhi një thirrje pa numër. E hapa. Ishte Rexha. Më tha se kishte pasur punë shumë dhe nga lodhja nuk kishte pasur as si t'më lajmërohej. Më tha se muajin tjetër do të vijë në Kosovë, jo se kishte punë, por që të takoheshim.

NGA BELGJIKA NË KOSOVË PËR NJË NJOHJE!

Thënë të drejtën, u befasova: tërë atë rrugë për një njohje!
Dhe, erdhi edhe dita të takoheshim.
Dola në aeroportin e Prishtinës dhe e pritja. Nga larg e njohja në bazë të fotove të

shumta që m'i kishte dërguar. Ishte edhe më i bukur se në foto...
Nga aeroporti u nisëm për në Rahovec me veturën time. Në hotelin "Nora", afër Klinës, u ndalëm në kafe.
Ndenjëm aty nga dy orë dhe, thënë shkurt, më pëlqeu shumë në bisedë...
E, kur u ndamë në Rahovec më tha se dëshiron të njihet edhe me familjen time. Dhe, ashtu ndodhi. Tri ditë më vonë ai erdhi te ne. U njohë me babanë dhe tim vëlla.
Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë edhe u fejua, ashtu shpejt e shpejt dhe u morëm vesh që gjatë verës edhe të martohemi, në mënyrë që të fillojë procedurën për bashkim familjar që të shkoja te ai.
Në muajin gusht u martuam me një dasmë shumë simbolike. Ai më mori me pak krushq dhe më dërgoi në shtëpinë e tij në periferi të Prizrenit.

MË KAPLUAN ETHET SE ISHTE NATA E PARË ME NJË MASHKULL!

Thënë të drejtën, para se të binim, më rrokën do ethe nga frika, sepse për mua

ishte nata e parë që bëja gjumë me një mashkull, andaj në kokë më sillleshin lloj-lloj mendimesh se si do të jetë hera e parë...
Dhe, hera e parë ndodhi shumë thjeshtë: Posa ramë në shtrat atë e zuri gjumi!
Në mëngjes u arsyetua se ishte i lodhur nga dasma dhe nuk kishte dëshirë që të bënim seks vetëm sa për sy e faqe...
Në natën e dytë, ende pa rënë me fjet, një telefonatë i erdhi nga Belgjika. Bosi e thërriste të kthehej menjëherë në punë! Kjo bëri që ai kinse u shqetësua. Andaj, edhe nata e dytë kaloi bosh...
Ditën e tretë e përcolla në aeroport dhe me një përqaftim e shtrëngim duarsh edhe u ndamë, ai duke hyrë në aeroport e unë duke u kthyer në shtëpinë e prindërve të mi...

DY VJET E MARTUAR DHE ENDE E VIRGJËR!

Tash, edhe pse së shpejti do bëhen dy vjet që jam martuar, ende jam virgjër! Ende pres se si do të jetë hera e parë...
E, si do të jetë ajo hera e parë një Zot e di?!
Dashuria, Rahovec



AVENTURA E JETËS
SUAJ TË RE FILLON KËTU!

ELIZA PARK



SUHAREKË

+383 44 106 777 1 | www.cimaks.com

KOMPLEKSI CIMA 2



PRISHTINË

+383 49 509 090 | www.cimaks.com

E kam emrin e keq: **Njerkë!**

Jam grua 48 vjeçe, e martuar para 22 vjetësh. Burri im ka qenë i martuar para se të martohej me mua. Me gruan e parë i kishte dy fëmijë, të cilët kishin mbetur të rriteshin me babën, meqë nëna i kishte braktisur.

Pas shtatë vjetësh martesë Agi, tash im burrë, ishte ndarë nga gruaja, me të cilën i kishte dy fëmijë të vegjël, njëri 5 vjeç e tjetri 7.

Pas ndarjes e ëma i kishte braktisur dhe ishte martuar me burrë tjetër, e unë u martova me burrin e saj, Agin. Thënë shkurt, u bëra nëna e dytë e fëmijëve të burrit, edhe pse në fillim nuk më

donin, sepse nuk ua qoja mallin e nënës së tyre.

I PATA DY E U BËRA ME TRE FËMIJË...

Tash e katër vjet jetoj me burrë dhe fëmijët e tij në Belgjikë. Në vitin e kaluar më ka lindur një vajzë, kështu që tash më duhet të kujdesem për tre fëmijë.

Por, problemi nuk është me fëmijët, ani pse fëmijët e burrit, sado që më respektojnë, shpeshherë kur nervozohen, më thonë: "Largohu, ti nuk je nëna jonë!".

Problemi është se prej fillimit që jam martuar me burrë gjithmonë kemi pasur fjalë, mosmarrëveshje, madje edhe për gjëra shumë të imta!

Madje, shpeshherë edhe e ofendojmë njëri-tjetrin, e unë po ndihem keq, meqë

jam tip i ndijshëm dhe më mbetet hatri sa herë që më ofendon...

JAM LODHUR NGA GRINDJET!

Sidoqoftë, mendoj se e dua burrin shumë, e edhe ai mua më do.

Por, grindjet e vazhdueshme, fjalët me ofendime, më kanë lodhur shumë!

E, të ndahem nga burri nuk mund ta bëj një gjë të tillë, sepse veç dashurisë që kam për të, nuk mund ta marrë me mend që vajza ime të rritet në duart e një njerke, sepse e di fort mirë se çka do të thotë fjala njerkë, të cilën gjë po e përjetoj qe sa vjet rresht!

Sepse, sado që jam sjell mirë me fëmijët e burrit, është vështirë njerkë të bëhet nënë e fëmijëve të huaj...

Vezirja, Belgjikë



Revolucion në DOBËSIM

E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë. Rugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë. Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm. Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përbushur ëndrrat e tyre.



Perforco
veten



Detoksifikoju



Relaksohu



Balanco
Shëndetin



PARA



PAS



PARA



PAS



PARA



PAS

Prishtinë
+383 45 224 540

Prizren
+383 43 900 902

Gjilan
+383 45 505 043

Gjakovë
+383 44 545 444

Jam bërë për hajmali të madhe!

Më është bërë bajat të flas a të shkruaj për politikë. Kisha dashur në këto çaste të jem bari e të ruaj bagëtinë. T'i kisha nja 100 krerë dele dhe t'i kullosja në kodrën time...

Dëshirën time që të kem dele ma prish uzurpimi i kodrës në fshatin tim të lindjes, sepse ish-kryetari i komunës njerit nga Maqedonia ia ka dhënë një truall për biznes të dhive mu te vendi i bukur, "Pishat". E, më vonë ai e uzurpoi tërë kodrën me sa e sa hektarë... Nuk më ka mbetur as të kem dëshira më, them me vete. Nuk mundet njeriu as të meditojë, sepse çfarëdo vendi të bukur natyror që ka ekzistuar, është uzurpuar dhe shitur nga shteti dhe nuk ka mbetur vend as për meditim. "Më falni", u them deleve të paragjykuara, "kullotni ku të mundni se kodrën time e kanë uzurpuar njerëzit e shtetit!".

PO T'ISHA HAXHI...

Më nuk dua të merrem me askënd, them me vete, por as delet nuk kam ku t'i kullos. Më së miri të isha haxhi dhe t'i kullosja nëpër arat e katundit, duke u bërë dëm të tjerëve, por me bindjen se sa ta kem kapelën e bardhë në kokë nuk do më rrahin...

Një shitës, nuk po ia përmendi emrin, e thyen shitoren e vet para nja 40 vjetësh dhe rastin e paraqet në polici. Policët me vete kishin marrë qenin nuhatës dhe e urdhërojnë: "Kape hajnin!".

E, qeni e kapë të zotin e shitores për këmbë...

Njëri prej policëve i thotë: "Ti je hajni, a?!". Ai e pranon, por polici tjetër e lut të mos tregojë se kanë qenë bashkë se do e burgosin edhe atë...

OSE VDES MBRETI OSE COFË GOMARI...

Kish dal Nastradini në treg të gomarëve. Secili gomar e kishin çmimin 100 lira, pos njerit që shitej 50.

"Pse ky është më i lirë?", e pyet Nastradini shitësin.

"Sepse është babai i gomarëve dhe është

më budallai nga të gjithë!", ia ktheu shitësi. Dhe, dëgjon mbreti se në pazar shitej babai i gomarëve...

E thërret Nastradinin që të mësojë më shumë për këtë rast. Nastradini i tha se babai i gomarëve, edhe pse më plakur, mund të mësohet të flasë!

Mbreti e pyet:

"Nastradin, për sa kohë e mëson ti atë gomar të flasë?"

"Për pesë a gjashtë vjet... Por, që ta mësoj gomarin plak të flasë më duhen para!", ia ktheu mbretit.

"Të jap një qyp lira, por nëse nuk e mëson gomarin të flasë ta heq kokën!", ia kthen mbreti.

Pas ujdisë Nastradini mori gomarin dhe qypin me lira dhe u kthye në shtëpi. Gruaja u befasua kur pa qypin me lira dhe iu drejtua Nastradinit:

"Ku e more qypin me lira?!"

"Ma dha mbreti, me kusht që gomarin që e solla në shtëpi ta mësoj të flasë brenda pesë a gjashtë vjetësh", ia ktheu ai.

"Po ku mësohet gomari të flasë, o njeri?!", ia ktheu ajo.

"Brenda këtyre viteve ose cofë gomari ose vdes mbreti!", ia ktheu Nastradini.

S.

Më shumë i frikësohem gruas

Dokumentet e Perandorisë Osmane nga Arkivi i Stambollit, ishin bërë sebeb për ta reflektuar në një serial jetën perandorake në shekullin që njihet si lulëzim i Turqisë, në rritjen e ushtrisë së shpatave dhe artilerisë së rëndë, që ishte parë për herë të parë në truallin e Evropës...

SI U KTHEVA 500 VJET PRAPA?

Kisha rënë të fjetja pak më herët se zakonisht, kur në ëndërr u bëra pjesë e të jetuarit në Turqinë e vitit 1523, të Sulltan Sulejmanit.

Nuk di si kisha arritur atje, por unë jetoja krah për krah me "Pargaliun", kryeministrin shqiptar nga Parga e Çamërisë, apo kjo kishte ndodhur për faktin se tri net më parë e kisha shkruar një poezi për Çamërinë, konkretisht për Pargën, qytetin e rrethuar në tri anët e saj nga deti, e që ishte një nga vendet e shenjta shkaku i masakrit të popullatës pargase, që kishte ikur në drejtim të Stambollit dhe qyteteve të Shqipërisë.

NGA NJË MJEGULL MË DOLI PARA SYMBYL AGA!

Teksa i bija Stambollit fund e krye, e që nuk kishte as fund e as krye, para meje u shfaqë Symbyl Aga, i cili më doli para nga një mjegull e dendur.

I matur në ecje, i veshur me pelerinën e gjelbër dhe mahramën, tregonte pozitën e tij në harem.

E unë, i shekullit XXI, me rroba kat, këmbë të bardhë, kravatë e flokë të krehur, dukeshin krejt tjetër karshi tij...

E përshëndes Symbyl Agën me "Mirëdita", e ai në vend të përshëndetjes ma kthen me një përlujtje koke.

Dhe, teksa qëndroja në parkun me lule, ku edhe ua merrja aromën e këndshme, në çast më vjen në mendje se çka do të bëja po të vjen dikush me shpatë, si në kohën e kryeministrit shqiptar të Pargës.

se sulltanit!



E, unë kurrë shpatë në dorë s'kam pasur, as që di si mbahet ajo, sa peshon ajo...

Dhe, teksa mendoja se isha njeri i një kohe krejt tjetër, shoh Lutfi Pashën kah vjen drejt meje.

U ngrita në këmbë dhe pa i thënë asgjë, pasi më shikoi, u kthye pas.

Pas pak m'u shfaq kryeministri shqiptar i Pargës. Desha t'i ofrohesha e t'i thosha se edhe unë jam shqiptar, por nuk dija nëse luante rol si sot nepotizmi dhe njohja, pa të cilën nuk mund as të ngihesh bukë!

Por, në këtë çast m'u kujtuan fjalët e një ministri në kohën e Hashim Thaçit, kur më tha: "Ligjin e shkelin vetëm ata që e bëjnë ligjin!"

Pargaliu shpatën e kishte në brez dhe herë pas herë e çonte dorën në dorezën e saj, duke reaguar nën instinktin e frikës së një sulmi që mund t'ia bëja, edhe pse ai s'e dinte se unë jo që nuk kisha shpatë si ai, por as brisk, siç thuhet në popull.

Dhe, teksa qëndroja stoik te parku, duke parë njerëz në kohë të ndryshme, goxha shumë isha mbushur vetëbesim e guxim... Ndërkohë, erdhën dy kalfa të haremit, të cilat i qortova për padrejtësi ndaj robërshave që detyroheshin të shërbenin në harem, përkundër asaj se ua kishin vrarë familjarët!

"Mos i torturoni robërshat! Edhe ju dikur keni qenë të tilla, e tash i keni duqet me alltën nën brekë!", u thashë.

Dhe, në çast më shfaqet para syve

profesori i Fakultetit të Mjekësisë, që e larguan këto ditë nga puna, me akuzën për ngacmim seksual, meqë u kishte thënë studenteve se po t'i kontrollonte në trup, ua gjente përgjigjet e pyetjeve nga provimet që i mbanin ato ditë...

Më vonë marrë vesh nga gruaja se ajo që kishte thënë profa, aludonte te kuptimi që studentet po i shënonin përgjigjet nëpër këmbë e mbi gjunjë, për ta dhënë provimin pa mësuar...

Heu, them me vete, pse u thashë kalfave të haremit se i kanë nën brekë duqet me alltën?! Edhe ato mund të më akuzojnë për ngacmim seksual!

Dhe, po më cilësuan me ngacmim seksual, jo vetëm që do bëhem horë e dheut, por do më shkatërrohet edhe familja, se gruaja do më bëj për pesë para!

JAM NË ZOR NGA GRUAJA IME!

Në ato çaste, për çudi, para më del gruaja dhe më qorton:

"Ku je deri tash?! A të thashë shko në furrë e blej bukë, apo të thashë shko në park e merru erë luleve?!"

Dhe, përnjëherë e ngritë dorën t'më mëshoj.

Por, nuk ma mëshon, se e di fort mirë se do e paraqes në polici për dhunë në familje, dhunë ndaj burrit.

S. Murturi

Pse fallxhorja na e qëllon fallin?

Realizimi i shumicës së fjalëve nga ana e fallxhoreve, është një gjë për të cilën jeni kureshtar edhe ju. Shumë prej jush mund ta keni rrotulluar filxhanin, të paktën, një herë për fall.

Dalja e shumicës së fjalëve të thëna nga ana e fallxhoreve, është një gjë për të cilin jeni kureshtar edhe ju. Mirëpo, cila është arsyeja e kësaj?

Mund të kuptohen fjalët standarde dhe njohja e disa gjërave nga personat e afërt kur shihni së bashku fall.

Mirëpo, çfarë ndodh kur fallin e shikojnë fallxhoret që merren enkas me këtë "punë"?

Si ndodh që të shpjegojnë ato që janë jetuar në të kaluarën dhe të sugjerojnë se çfarë do ndodhë më tej në të ardhmen?

FALL I NJËJTË PËR TË GJITHË!

Kjo teori, e cila në literaturë është e njohur me emrin "Efekti i Barnumit", në të vërtetë, bazohet në themelet e fallit të njëjtë për të gjithë.

Teoria në fjalë, që njihet edhe si "Efekti Forer", është një vëzhgim që përshkruan tendenca për rezultate të larta të parashikimit të paqartë të personaliteteve të tyre, i cili është përgatitur pothuajse për vetë ata.

Mirëpo, e vërteta është se këto parashikime i përshtaten shumicës së njerëzve. Japim një shembull, e që u jetua gjatë historisë, në lidhje me këtë. Lektor B. R. Forer që në vitin 1948 është marrë me këtë çështje.

Ai i shpërndau letrat me fall të njëjtë për të gjithë studentët e tij dhe kërkoi prej tyre t'i shënojnë ato të cilat u përshtaten atyre.

Në letër shkruante: "Keni nevojë që të tjerët t'u pëlqejnë dhe t'u admirojnë, por në të njëjtën kohë keni tendencë të jeni autokritikë ndaj vetes.

Personaliteti juaj ka disa anë të dobëta. Por, zakonisht, keni aftësi t'i kompensoni ato. Keni kapacitet të madh, të cilin nuk e përdorni për ta kthyer në favorin tuaj. Ndërsa, në pamje të jashtme dukeni si të disiplinuar dhe plot vetëbesim, në brendësinë tuaj jeni të shqetësuar. Ngandonjëherë në mendjen tuaj lindin dyshime serioze se a keni marrë vendim të duhur apo jo ose a keni pasur të drejtë apo jo.

Ju preferoni një sasi të caktuar ndryshimesh, ndalesat dhe kufizimet u bëjnë të palumtur. Jeni krenarë nga të qenit një

mendimtar i pavarur, ndërsa nuk i pranoni pretendimet e të tjerëve pa pasur prova të kënaqshme, por gjatë rrëfimit tuaj nuk e gjeni të drejtë që të hapeni para dikujt tjetër. Ndonjëherë jeni të hapur, gjakftohtë dhe social, ndërsa ngandonjëherë jeni të mbyllur në vetë, të frikësuar dhe bëheni të fshehtë. Ndonjëherë keni edhe dëshira joreale".

FJALËT QË UA THOTË FALLXHORJA NUK JANË POSAÇËRISHT PËR JU!

Prej studentëve u kërkua që tekstet e shkruara në letër t'i vlerësonin me 1 deri në 5, për ato të cilat i përshkruanin ata më së miri.

Ndërkaq, mesatarja e këtij vlerësimi ka qenë 4.20 pikë. Me këtë studim Forer arriti në rezultatin se njerëzit kanë tendencë t'i perceptojnë këto fjalë, të cilat mund t'i përshtaten pothuajse të gjithë njerëzve, si të jenë shkruar për vetë ata.

Prandaj, ato fjalë që u thonë fallxhoret janë "fjalë të përgjithshme", për të gjithë. Nuk janë të posaçme vetëm për ju.

TRAJTIMET ESTETIKE TË KOKËS DHE QAFES



Mbjellja e
Flokëve



Blepharoplasty



Facelift



Otoplasty



Rhinoplasty



Ngritje e
vetullave



Foxy Eyes



Chin
Liposuction



Chin Implant



Cheek Bones
Implant



Cantopexy



Lip Lift

Rr. Zef Jubani, Veternik - Prishtinë (Hyrja për në autostradë)

+383 (0) 45 707 744 | +383 (0) 43 707 744

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

A do bashkohem me fëmijët e mi?

Përrshëndete, jam e martuar që 28 vjet. Burrin e kam në Perëndim me fëmijë që tetë vjet. Vjen në pushim dimrit, por nuk kalojmë mirë. Nuk e jep maksimumin për mua.

Më ka lënë pas dore...

A kam shpresë të bashkohem me burrin dhe fëmijët?

"E pakënaqura"

Përgjigje:

Fakti se nuk jeni bashkë tregon se bashkëshortësia juaj nuk ka shkuar mirë. Keni probleme që nuk i përkasin magjive, por gjërave reale të jetës së përditshme.

Shoh shumë vështirësi në bashkimin tuaj, sepse ndikimi i babait të fëmijëve te ta është shumë i madh dhe pa ndryshuar tashmë ky raport mes tyre nuk shoh se ti po bashkohesh me ta.

A do ta takoj përsëri?

Jam grua, 25-vjeçare, e martuar. E kam një fëmijë. Pas një lidhje me një djalë jam dashuruar shumë në të.

A do të jem me të?

"Nita 99"

Përgjigje:

Dëshira për ta takuar të dashurin të sjellë probleme, sepse ti je grua e martuar. Lidhja jote e re, si grua e martuar, ta rrezikon jetën bashkëshortore, për çka të kisha sugjeruar të mos e takosh më...

Kam frikë se po vdes!

Jam një djalë, 30-vjeçar. Që 5 vjet jetoj me frikë.

Kam qenë i sëmurë dhe ende jam me probleme.

Kam qenë te shumë hoxhallarë. Më kanë thënë se kam magji.

Kam bërë analiza dhe të gjitha më dalin mirë...

Kam frikë se do vdes! Jam shumë në siklet...

Të lutem, më jep përgjigje!

"..."

Përgjigje:

Nëse i referohemi anës praktike të sëmundjeve njerëzore, janë dy grupe sëmundjesh:

Sëmundjet e dukshme dhe të padukshme.

Sëmundjet e dukshme janë ato që reflektojnë përmes sistemit laboratorik medicinal, që pasqyrohen nga analizat e gjakut, të urinës, si dhe analizave të tjera,

e deri te pamjet radiologjike.

Ndërsa, sëmundjet e padukshme janë ato që nuk shfaqen përmes analizave, por që ekzistojnë brenda njeriut.

Nëse një person di se është i sëmurë, e analizat tregojnë të kundërtën, këtu kemi të bëjmë me probleme të natyrave të ndryshme, prej atyre të psiko-zave neurologjike, stresore etj. Shumica e këtyre problemeve konsistojnë në gjendje frike, që i përgjigjen nivelit të frikës nga vdekja, e që janë produkt i raporteve konservative në familje dhe rreth saj.

Në rastin tënd, kjo gjendje nuk shërohet me barëra, me farmaci, por ky problem do qasje tërësisht edukative, apo trajtim alternativ, që e mbushë shpirtin e të prekurit besim dhe pajtim me parimet e raporteve lindje-vdekje.

Jam më e vjetër se i dashuri, a do jemi bashkë?

Jam në lidhje me një djalë. E dua shumë. Edhe ai më thotë se më do, por dyshoj shumë, sepse ka edhe vajza të tjera që shprehin dashuri ndaj tij. Kemi dallim në moshë, sepse jam më e vjetër se ai...

Çfarë të ardhme kam me të?

"Lora"

Përgjigje:

Në rrethanat tona nuk preferohet që vajza të jetë më e vjetër se djali, sepse herët a vonë dikush nga familja e tij ka për të thënë se ti je më e vjetër dhe se nuk e ke merituar djalin, vëllanë e tyre! Andaj, edhe pse duheni, të kisha preferuar të mos bashkoheni!

Jam e ndershme, e moralshme, por e pafat!

Jam Flora, nga Prishtina, 42-vjeçare, e pa martuar. Çdo ofertë më dështon! Më ofrohen ofertat, por pa sukses! Jam shumë e singertë, e moralshme. Më brengos fati, sepse jam lodhur nga pritjet e shumta dhe të parealizueshme!

Ju lutem, më ndihmoni ta gjej fatin dhe të filloj një jetë të re!
"Floree"

Përgjigje:

Sot morali është sfidë, edhe pse është një tipar shumë i rëndësishëm njerëzor, por shumë sfidues nga koha jonë.

Jemi duke jetuar në frymën e kulturave të BE-së dhe integriteteve, të cilat janë duke i devaluuar vlerat morale dhe duke jetësuar mënyrat e lira dhe demokratike të jetës dhe punës.

Dhe, karshi këtyre sfidave sot morali është armiku i njeriut. Kur po e them këtë gjë, nuk po them të mos jetë njeriu i ndershëm e i moralshëm, por do tërheqë vërejtjen mbi atë se çka ke fituar ti, për shembull, që je kaq e veçantë në jetë?!

E ke bërë këtë moshë, në të cilën ke rrezikuar martesën, duke mbetur anash zgjidhjes së këtij problemi!

Por, nuk është as vonë ta gresh fatin...

Këshilla ime është të përshtatesh në trendin jetësor dhe ta kërkosh rangun tënd.

Ti duhet t'i kthehesh shoqërimit, sepse në këtë mënyrë nuk do të ndjehesh e vetmuar, por do të ndjehesh e plotësuar. Izolimi të ka bërë t'i shohësh njerëzit ndryshe nga që janë ata!

Pse stresohem lehtë?!

Jam grua, 45-vjeçare. I kam tre fëmijë. Me shëndet nuk jam mirë. Qe dy muaj e kam bërë operacion heqjen e mitrës, por problemi është se që 16 vjet jam me shqetësime. Kam frikë nga vdekja, por edhe sëmundja! Përdori terapi të psikiatrit, por pa sukses...

Stresohem për gjithçka! Edhe me burrë kam probleme. Vitin e kaluar ka pasur lidhje me një femër të huaj dhe tërë kohën sa ka qenë me të është sjellë shumë keq me mua e me fëmijë.

Kur e zura me fakte, në vend se të kërkonte falje që kishte shkuar në pushim me të, ai u soll me agresivitet, duke më bërtitur pse ia kam kontrolluar telefonin...

Ju lutem, më ndihmoni, sepse nuk ndjej gëzim në shpirt, por më rri një mërzi tërë kohën, e cila më përcjell me stres.

"Pa shifër"

Përgjigje:

Problemi yt i ka dy dimensione: Një, je bërë e ndjeshme, meqë burri ka bërë lëvizje tradhtie ndaj teje dhe ti e ke zënë në flagrancë, edhe pse shumë më mirë do kishte qenë të mos hysh në detajet e jetës së tij, meqë as ti nuk je e aftë ta bësh burrin të kënaqur e të lumtur aq sa i duhet atij.

Dy, dimensionin e jetës tënde bashkëshortore është depressionuar dhe nuk funksionon lidhja emocionale mes jush. E, problemi i frikës do konsultim me psikiatrin, për të gjetur një rrugë që ta heqë frikën.

Nuk duhet të qëndrosh në

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

hapësirë të mbyllur, në ashensor vetëm, e të ngjashme...

A më bëri magji vajza që e desha dhe që e dua?

Jam burrë. Kam grua dhe tre fëmijë. Gruaja i ka të gjitha të mirat si grua...

Por, budallakia është në mua, sepse nuk po mund të pajtohem me vite e vite...

E kam dashur një vajzë qysh në rini, por familjet tona nuk na lanë të bashkohemi, sepse kishte fanatizëm të madh.

Kur e kuptoi familja e saj se ajo më donte, e martuan për një burrë mjaft të moshuar!

E kam pritur shumë vjet se do të ndahet nga ai e do martohemi. Por, me kohë u binda se një gjë e tillë kishte perënduar. Sidoqoftë, nuk kam mundur ta dua gruan dhe gjithmonë kam jetuar si në ëndërr!

A do ta harroj atë femër, apo do ta kem herë do kur grua?

"Kujtimi i paharruar"

Përgjigje:

Para së gjithash, mindilin që e ruan ti, e që e ke kujtim prej saj, ta kujton kohën e rinisë.

Por, gjërat kanë ndryshuar, sepse jeta e saj ka ecur në drejtim të kundër me tëndin...

Andaj, edhe po të keni mundësi të martoheni, do vëresh se ajo më nuk është e dikurshmja kur i ruanit delet bashkë, sepse gjërat kanë ndryshuar...



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE